



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 302 Akti

Nr. 451 Vendimi
Tiranë, më 23.9.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli Kryesuese
Pamela Qirko Relatore
Olsi Komici Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Branko Hrvatin, në Tiranë, më 21 shtator 2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Izet Dushaj, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës.**

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Pamela Qirko, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura gjatë hetimit administrativ, në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në nenin 179/b, paragrafi 5 të ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe, në nenin 3, pika 5 dhe nenin 5, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Subjekti i rivlerësimit, z. Izet Dushaj, me funksionin gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës, është subjekt që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në nenin 14, pika 2 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si “Komisioni”), zhvilloi procedurën për shpërndarjen e çështjeve me short në trupa gjykues, në datën 15.3.2019, nga e cila rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Izet Dushaj, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Firdes Shuli dhe Olsi Komici. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioneri znj. Pamela Qirko.
4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 27.3.2019 u caktua me mirëkuptim kryesuese znj. Firdes Shuli, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Izet Dushaj.
5. Referuar pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për z. Izet Dushaj nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë” të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës” të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.
8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale” të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.
9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ).

10. Inspektorati i Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), ka dërguar një raport¹ të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Izet Dushaj, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë dhe;
- nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

11. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin/raportet e mbajtur/a për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

12. Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport² të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim, janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga pika 5 e nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vlerësoi se ato arrijnë nivelin e provueshmërisë dhe, në datën 28.7.2021, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht, duke u bazuar vetëm në kriterin e pasurisë për subjektin e rivlerësimit, z. Izet Dushaj; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40, 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

15. Po në datën 28.7.2021, subjektit të rivlerësimit iu dërguan rezultatet e hetimit administrativ dhe analiza financiare e kryer nga Komisioni, u njoftua mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/shpjegime apo të kërkonte depozitimin e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, duke i dhënë 30 ditë kohë për të marrë akses në dosjen e rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes më 30.7.2021, duke disponuar kopjen e saj në format elektronik (CD). Në datën 3.8.2021, përfaqësuesi i autorizur prej tij, z. Eritan Shehu, mori një kopje e plotë fizike e dosjes së hetimit, mbi bazën e të cilit janë përpiluar rezultatet e hetimit administrativ.

¹ Akti i kontrollit nr. *** prot., datë 24.5.2018.

² Raporti për analizimin e aftësive profesionale me nr. *** prot., datë 4.3.2020.

16. Në datën 25.8.2021 subjekti i rivlerësimit depozitoi në rrugë elektronike (me e-mail) kërkesën për shtyrjen e afatit të përcaktuar nga Komisioni për dorëzimin e shpjegimeve dhe provave për të kundërshtuar rezultatet e hetimit, kërkesë e cila u pranua nga Komisioni. Subjektit iu caktua afat i ri për dërgimin e prapësimeve, deri në datën 16.9.2021.

17. Në datën 16.9.2021, nëpërmjet postës elektronike, po ashtu edhe me materialet e depozituara në protokollin e Komisionit³, subjekti ushtroi të drejtën e prapësimeve dhe njëkohësisht kërkoi riçeljen e hetimit administrativ dhe vlerësimin edhe për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, atë të kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale.

18. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim kërkesën për riçeljen e hetimit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit, në datën 17.9.2021, vendosi⁴ mospranimin e saj.

19. Pas shqyrtimit shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë z. Izet Dushaj në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

20. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, me e-mail, në datën 17.9.2021.

20.1. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 21.9.2021, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati Kongreseve), salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin.

20.2. Subjekti i rivlerësimit, z. Izet Dushaj dhe përfaqësuesi ligjor i zgjedhur prej tij, z. Eritan Shehu, morën të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet në lidhje me procesin e rivlerësimit dhe për të kundërshtuar rezultatet e hetimit administrativ kryesisht për sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Izet Dushaj, kërkoi riçeljen e hetimit për 2 kriteret e tjera dhe, në rast mosriçeljeje, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

21. Z. Izet Dushaj ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë të gjithë procedurës së hetimit administrativ.

21.1. Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

22. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

³ Protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 16.9.2021.

⁴ Vendimi i ndërmjetëm nr. *** , datë 17.9.2021.

22.1. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

22.2. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

22.3. Por, referuar vendimit nr. 2/2017⁵ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22.4. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

23. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe të ligjshmërisë së burimit dhe të krijimit të saj.

23.1. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, të paraqitur më parë në ILDKPKI, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Izet Dushaj.

⁵ “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

23.2. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur si edhe verifikimin e ligjshmërisë së të ardhurave të deklaruara si burim krijimi të pasurive. Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2) të dorëzuar në ILDKPKI më 25.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë deklaruar këto pasuri (të luajtshme dhe të paluajtshme):

24. Pasuria e llojit “apartament banimi”, me sipërfaqe 158 m², ndodhur në rrugën “***” (ish-rruga “***”), pranë Qytetit Studenti, Tiranë, me vlerë 60,000 euro, blerë me kontratën e shitblerjes së datës 3.1.2011. Subjekti ka deklaruar se zotëron 50% pjesë takuese mbi këtë pasuri. Subjekti ka shpjeguar se shuma prej 50,000 eurosh është deklaruar dhe paguar më parë, ndërsa shuma prej 10,000 eurosh është paguar në momentin e lidhjes së kontratës së hipotekimit, me burim pakësimin e gjendjes *cash* dhe të ardhurat ndër vite.

24.1. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar: (i) të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit të banimit në Bajram Curri, në shumën 30,000 euro, sipas kontratës së datës 6.11.2008 (përfituar falas më parë prej tij, si ish- i përndjekur politik); (ii) shumën 5,000 paund të dhuruar nga vëllai i tij, E.D, konfirmuar me deklaratën noteriale të datës 23.3.2015; dhe (iii) kursimet ndër vite të deklaruara më parë, pjesa e mbetur në shumën prej 22,000 euro.

Deklarimi i kësaj pasurie në vite

25. Në deklaratën e interesave private (këtej e në vijim DIP) të vitit 2008, të depozituar nga subjekti në ILDPKI, në seksionin e ndryshimeve të interesave private – pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar: **(1) shitjen e apartamentit** në Bajram Curri (deklaruar më parë) në shumën 30,000 euro; **(2) blerjen e një apartamenti** me sipërfaqe 98 m², ndodhur në rrugën “***”, Qyteti Studenti, Tiranë, në vlerën 50,000 euro, me burim krijimi: (a) të ardhurat nga shitja e apartamentit në Bajram Curri; (b) pakësimi i gjendjes *cash* në vlerën 1,100,000 lekë (deklaruar në vitet 2005, 2006, 2007); (c) pakësimi i gjendjes *cash* në valutë prej 5,000 paundësh; dhe (4) pjesa e mbetur nga kursimet e vitit 2008.

25.1. Rezulton se në DIP 2008 subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar detyrime financiare ndaj personave fizikë apo juridikë.

25.2. Në DIP/2011 subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit “apartament banimi” me sipërfaqe 98 m², deklaruar më parë në bazë të kontratës së sipërmarrjes, i cili është hipotekuar së bashku me një sipërfaqe shtesë prej 60 m², me vlerë 60,000 euro, sipas kontratës së datës 3.1.2011.

25.3. Gjithashtu, në deklarimin e bërë në DIP/2011, subjekti ka sqaruar se vlera prej 50,000 eurosh është paguar dhe deklaruar më parë, ndërsa vlera prej 10,000 eurosh është paguar në momentin e lidhjes së kontratës për hipotekim, me burim pakësimin e gjendjes *cash* dhe të ardhurat nga pagat.

Hetimi/verifikimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri

26. ASHK- ja Drejtoria Vendore Tirana Jug⁶ informon se në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 28.1.2011, figuron e regjistruar pasuria në emër të subjektit të rivlerësimit, me kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.1.2011, redaktuar nga notere E.K, porse kjo kontratë rezulton në mungesë në arkivin fizik të dokumentacionit të regjistrimit. Nga kartela e pasurisë së paluajtshme, bashkëlidhur shkresës, rezulton se apartamenti me sipërfaqe 158 m² figuron ende në emër të shitësit, shtetases E.Xh.

⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 20.8.2020.

26.1. Rezulton nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje se në datën 20.3.2007, subjekti i rivlerësimit ka porositur⁷ nga sipërmarrësi dhe investitori, znj. E.Xh, një apartament me sipërfaqe 169 m², të ndodhur në objektin godinë 8 kate + 1 kat nëntokë. Godina është ndërtuar nga sipërmarrësi, E.XH, në truallin në pronësi të saj, të regjistruar në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 23.4.2003, me nr. pasurie ***, e ndodhur në zonën kadastrale ***, rruga “***”, Tiranë, e cila në bazë të formularit të vetëdeklarimit rezulton se është në proces legalizimi. Çmimi i shitblerjes së pasurisë është përcaktuar 60,000 euro, i cili është likuiduar totalisht në ditën e nënshkrimit të kontratës.

26.2. Në datën 3.1.2011, subjekti i rivlerësimit dhe znj. E.Xh kanë nënshkruar kontratën e shitblerjes së pasurisë objekt vlerësimi, apartamentit me sipërfaqe 158 m², i ndodhur në katin e tretë të godinës 8 kate, në rrugën “***”, Tiranë, regjistruar në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 28.12.2010, pasuria nr. ***, zona kadastrale ***. Në këtë kontratë është referuar çmimi prej 60,000 eurosh për blerjen e apartamentit objekt transaksioni, si edhe përcaktohet se blerësi, z. Izet Dushaj, e pranon blerjen e pronës si dhe likuidon shitësin plotësisht jashtë zyrës në të cilën redaktohet ky akt.

26.3. Sa më sipër, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar porositjen e këtij apartamenti në DIP/2007 - të drejtat reale mbi të. Gjithashtu, rezulton se ka mospërputhje mes deklarimeve të kryera nga subjekti në DIP-të 2008, 2011 dhe përcaktimeve të bëra në kontratën e porosisë së vitit 2007 dhe kontratën e shitblerjes së vitit 2011, për sa i përket sipërfaqes dhe momentit të pagesës së çmimit për blerjen e kësaj pasurie.

26.4. Subjekti është pyetur nga ILDKPKI-ja⁸ për mospërputhjet e konstatuara midis deklarimit në DIP/2008 dhe përcaktimeve të bëra në kontratën e sipërmarrjes së vitit 2007, lidhur me sipërfaqen dhe çmimin. Gjithashtu subjektit i janë kërkuar shpjegime për mungesën e deklarimit të kësaj pasurie në DIP/2007 dhe arsyes së deklarimit të çmimit të blerjes në vlerën 50,000 euro. Në përgjigje, subjekti ka deklaruar se: **a)** pagesa është kryer nga të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në Bajram Curri, në shumën 30,000 euro në datën 6.11.2008; **b)** pavarësisht kontratës së porosisë, likuidimi total do të kryhej pas regjistrimit të pasurisë në ZRPP, pasi në atë kohë godina ishte në proces legalizimi; **c)** pasaktësia në deklarimin e sipërfaqes ka ardhur si pasojë e mospasjes së kontratës së porosisë në momentin e deklarimit.

26.5. I pyetur sërish nga ILDKPKI-ja⁹ lidhur me problematikat e konstatuara në deklarimin e kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit me anë të shkresës së datës 16.11.2014¹⁰ ka parashtruar se *në momentin e hipotekimit të këtij apartamenti nga firma ka marrë edhe një shtesë prej 60 m², ngjitur me apartamentin e tij, me një çmim prej 10,000 euro të pasqyruara në momentin e lidhjes së kontratës së hipotekimit të plotësuar nga pakësimi i gjendjes cash dhe të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes. Në vijim ka sqaruar se fakti që në hipotekë është regjistruar 169 m², do të thotë se është apartamenti i deklaruar më parë me sipërfaqe 98 m² + 60 m² shtesë, që bëjnë 158 m². Diferenca prej 11 m² janë sipërfaqe e përbashkët e apartamentit, dhe se ai ka deklaruar vetëm sipërfaqen brenda apartamentit që ka blerë...Çmimi prej 60,000 euro është çmimi prej 50,000 euro apartamenti me sipërfaqe 98 m² dhe 10,000 euro, apartamenti shtesë 60 m².*

⁷ Kontratë porosie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.3.2007.

⁸ Procesverbali i datës 8.7.2011 “Mbi shpjegimet e suobjektit të deklarimit të pasurive”, përcjellë nga ILDKPKI-ja në Komision me shkresën nr. *** prot., datë 1.7.2020.

⁹ Pyetësor i drejtuar subjektit, përpiluar në datë 5.11.2014, nga inspektori I ILDKPKI, znj. Dh.S, pjesë e dokumentacionit të dërguar nga ILDKPKI me shkresën nr.*** prot., datë 1.7.2020.

¹⁰ Pjesë e dokumentacionit të dërguar nga ILDKPKI me shkresën nr.*** prot., datë 1.7.2020.

26.6. Ndërsa, i pyetur nga Komisioni lidhur me këtë pasuri për pasaktësitë dhe mospërputhjet e konstatuara në deklarinimin e saj¹¹, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, midis të tjerash se ka nënshkruar kontratë porosie me shtetasen E.Xh në datën 20.3.2007, nr. *** rep., nr. *** kol., në bazë të së cilës do të blinte apartament me sipërfaqe 168 m², (98 m², i përfunduar, ndërsa pjesa tjetër e tij prej 60 m² nuk kishte përfunduar në të gjitha punimet) kundrejt çmimit prej 60,000 (gjashtëdhjetë mijë) euro, por për shkak se kontrata ishte tip dhe marrëdhënia në mirëbesim të plotë, nuk i kanë kushtuar vëmendjen e duhur nenit 2 të kësaj kontrate ku thuhej se çmimi prej 60,000 eurosh është likujduar plotësisht, as ai dhe as pala shitëse. Duke qenë se në vitin 2007 nuk kishte kryer asnjë pagesë për blerjen dhe objekti vazhdonte të ishte i palegalizuar nuk e ka deklaruar këtë kontratë në deklarinimin periodik të vitit 2007. Pagesën e parë për blerjen e këtij apartamenti në shumën prej 50,000 euro e ka bërë në vitin 2008, kohë në të cilën kishte shitur shtëpinë në Bajram Curri, duke shtuar dhe kursimet e tij, si dhe një shumë të dhuruar nga vëllai i tij shtetasi E.D, i cili jetonte dhe vazhdon të jetojë në Mbretërinë e Bashkuar. Në deklarinimin e vitit 2008 ka pasqyruar këtë pagesë duke përcaktuar sipërfaqen 98 m², pasi ajo ishte sipërfaqja që shfrytëzonte realisht, pasi pjesa tjetër prej 60 m² nuk kishte përfunduar akoma. Me përfundimin e plotë të punimeve dhe legalizimin e objektit në vitin 2011, ka bërë pagesën e shumës prej 10,000 eurosh dhe ka lidhur kontratën përfundimtare të shitjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.1.2011. Të gjitha pagesat janë bërë me para në dorë. Kontratat e ujit dhe të energjisë Elektrike janë lidhur në dhjetor 2007.

26.7. Në mbështetje të deklarinimit të tij, krahas kontratës së porosisë së vitit 2007 dhe kontratës së shitblerjes të vitin 2011, subjekti ka depozituar: (i) deklaratë noteriale të shtetasës E.Xh nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.7.2020; (ii) shkresë nr. *** prot., datë 7.7.2020, nga UKT sh.a., Tiranë; (iii) vërtetim nga OSHEE (FSHU) nr. *** prot., datë 2.7.2020.

26.8. Nëpërmjet deklaratës noteriale të datës 6.7.2020, shtetasja E.Xh ka deklaruar se në rrugën “***”, në vitin 2003 ka ndërtuar një godinë banimi 8 kate dhe 1 kat nëntokë, në truall në pronësi të saj. Në vitin 2007 kur ka përfunduar pjesën më të madhe të ndërtimit dhe ka filluar shitjen e apartamenteve të këtij objekti i cili ishte në procedurë legalizimi, në katin e tretë të tij i ka shitur shtetasit Izet Dushaj një apartament me sipërfaqe 158 m². Fillimisht në vitin 2007, për shkak të njohjes familjare që kanë pasur bashkë, i ka ofruar shitjen e këtij apartamenti blerësit Izet Dushaj, pagesën e të cilit do ta bënte kur të kishte mundësinë financiare. Pasi ranë dakord për çmimin, në vitin 2007 kanë nënshkruar një kontratë porosie me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.3.2007, në kohën që apartamenti nuk kishte përfunduar plotësisht, me qëllim që blerësi të lidhte kontratat e ujit edhe energjisë elektrike, praktikë e ndjekur prej saj pothuajse me të gjitha apartamentet e tjera të shitura. Sqaron se, duke qenë se kontrata ishte tip si për të gjithë apartamentet e tjera në të është shënuar gabimisht se është bërë pagesa e plotë e shumës prej 60,000 euro, por ky shënim nuk është korrigjuar për shkak të marrëdhënies së mirëbesimit të plotë mes tyre. Këtë apartament ia ka dorëzuar blerësit Izet Dushaj pjesërisht të përfunduar në shtator të vitit 2007, në sipërfaqen 98 m² dhe pjesën tjetër të punimeve e ka përfunduar në vitin 2010 për sipërfaqen prej 60 m². Shtetasi Izet Dushaj pagesën e parë për blerjen e apartamentit në shumën 50,000 euro e ka bërë me para në dorë në dhjetor të vitit 2008, ndërsa pjesën e mbetur prej 10,000 euro e ka bërë në vitin 2011, kohë në të cilën kishin përfunduar të gjitha punimet në apartament (edhe shtesën prej 60 m²) dhe të dyja pagesat janë bërë me para në dorë.

¹¹ Pyetja nr. 1 e pyetësorit nr. 2 të dërguar nga Komisioni.

26.9. Sa më sipër, rezulton se subjekti ka dhënë shpjegime kontradiktore lidhur me mosdeklarimin e sipërfaqes së plotë të këtij apartamenti apo sipërfaqes shtesë prej 60 m² dhe mënyrën e përfitimit të saj.

26.10. Për më tepër konstatohet se, edhe pse subjekti ka deklaruar për herë të parë në vitin 2008 porositjen e kësaj pasurie dhe pagesën e kryer në shumën prej 50,000 euro, nuk rezulton të ketë deklaruar detyrime të mbetura ndaj shitësit që lidhen me kontratën e porosisë së vitit 2007, në të cilën është përcaktuar çmimi prej 60,000 eurosh për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi.

26.11. Nisur nga përcaktimet e bëra në kontratën e porosisë së vitit 2007, si dhe duke marrë në konsideratë faktin se subjekti nuk ka deklaruar në DIP/2007 porositjen e këtij apartamenti dhe interesat privatë të lidhura me të, si edhe për shkak të mospërputhjeve të konstatuara në deklaratimet e bëra, rezulton se pagesa prej 60,000 euro për blerjen e kësaj pasurie është kryer në datën 20.3.2007, në momentin e nënshkrimit të kontratës së porosisë, dhe si e tillë është pasqyruar në analizën financiare paraprake të kryer nga Komisioni.

26.12. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet/shpjegimet e tij përfundimtare dhe të depozonte prova të reja të mundshme, lidhur me mosdeklarimin e pasurisë objekt vlerësimi në DIP/2007, mospërputhjeve dhe deklaratimeve kontradiktore të bëra ndër vite dhe të konstatuara nga Komisioni, si edhe faktit të pasqyrimin në analizë financiare të kryerjes së pagesës prej 60,000 euro për blerjen e këtij apartamentit në datën 20.3.2007.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

27. Lidhur me mospërputhjet mes deklaratimeve të kryera nga subjekti në DPV-të 2008, 2011 dhe përcaktimeve të bëra në kontratën e porosisë së vitit 2007 dhe kontratën së shitblerjes së vitit 2011, përsa i përket sipërfaqes dhe momentit të pagesës së çmimit për blerjen e kësaj pasurie, me dërgimin e prapësimeve, subjekti i rivlerësimit u ka qëndruar shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ, duke parashtruar në mënyrë të pëmbledhur se:

-Në vitin 2007 duke qenë se kishte vendosur të shiste shtëpinë në Bajram Curri dhe të vinte me banim në Tiranë, filloi të shikonte mundësinë për të blerë një shtëpi në Tiranë.

*-Për shkak të njohjes familjare dhe lidhjeve miqësore mori dijeni për faktin se shtetësja E.Xh kishte ndërtuar një objekt në rrugën “****” dhe kishte apartamente në shitje. Objekti ishte në proces legalizimi.*

-Për këtë arsye, duke qenë se në atë kohë nuk i kishte as paratë e nevojshme për blerjen e apartamentit, pasi nuk e kishte shitur akoma shtëpinë në Bajram Curri, bisedoi me këtë shtetase për mundësinë e blerjes së një apartamenti në objektin që ajo kishte ndërtuar dhe ranë dakord që ajo ti shiste apartamentin ku banon, i cili ndodhet në katin e tretë të pallatit dhe ishte i papërfunduar në të gjithë sipërfaqen e tij, por vetëm në pjesën prej 98.m², ndërsa për pjesën tjetër të tij prej 60 m, nuk i kishte përfunduar të gjitha punimet.

-Duke qenë se kishin miqësi familjare, ranë dakord që një pjesë të pagesës ta bënte pasi të shiste shtëpinë në Bajram Curri dhe pjesën tjetër kur të përfundonin punimet në pjesën e papërfunduar dhe kur të bëhej legalizimi i banesës.

-Ndodhur në këto kushte kur në vitin 2007 nuk kishte paguar akoma asgjë për blerjen e kësaj shtëpie dhe objekti vazhdonte të ishte i palegalizuar, nuk e ka deklaruar këtë kontratë në deklaratimin periodik të vitit 2007, pasi realisht nuk kishte paguar asgjë akoma për blerjen e tij.

-Pagesën e parë për blerjen e këtij apartamenti në shumën prej 50,000 eurosh e ka bërë në 20 nëntor të vitit 2008, kohë në të cilën kishte shitur shtëpinë në Bajram Curri, duke shtuar kursimet e tij si dhe një shumë të dhuruar nga vëllai, shtetasi E.D, i cili jetonte dhe vazhdon të jetojë në Mbretërinë e Bashkuar.

27.1. Në mbështetje të shpjegimeve të tij, subjekti ka depozituar si prova të reja, 2 mandatarkëtimi të firmosura nga E.Xh, të vulosura me vulën e subjektit “****”, përkatësisht mandatin nr. ***, datë 20.11.2008 në shumën 50,000 euro me përshkrimin “Kësti i parë për shtëpi” dhe mandatin nr. ***, datë 7.12.2011 në shumën 10,000 euro, me përshkrimin “Kësti i dytë për shtëpi”.

27.2. Edhe lidhur me mospërputhjet/deklarimet kontradiktore mbi sipërfaqen dhe çmimin e paguar/momentin e pagesave për apartamentin në Tiranë, subjekti u ka qëndruar shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur se:

-Pasqyrimi i blerjes së kësaj pasurie në analizën financiare të vitit 2007 i këtij fakti, nuk i përgjigjet realitetit dhe rëndon padrejtësisht pozitën e tij si subjekt i rivlerësimit.

-Pagesën e parë për blerjen e këtij apartamenti në shumën prej 50,000 euro, e ka bërë në vitin 2008, kohë në të cilën kishte shitur shtëpinë në Bajram Curri, duke shtuar dhe kursimet e tij si dhe një shumë të dhuruar nga vëllai, E.D, i cili jetonte dhe vazhdon të jetojë në Mbretërinë e Bashkuar.

*-Në deklarin e vitit 2008 ka pasqyruar këtë pagesë duke përcaktuar sipërfaqen 98 m², pasi ajo ishte sipërfaqja që shfrytëzonte realisht, pasi pjesa tjetër nuk kishte përfunduar akoma. Me përfundimin e plotë të punimeve dhe legalizimin e objektit në vitin 2011, ka bërë pagesën e shumës prej 10,000 eurosh dhe ka lidhur kontratën përfundimtare të shitjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 03.01.2011. Të gjitha pagesat janë bërë me para në dorë. Këtë apartament e ka marrë në dorëzim në shtator të vitit 2007. Në të vërtetë në momentin e lidhjes së kontratës për arsye të miqësisë familjare me shitësen nuk ka bërë asnjë pagesë. Kjo është realisht situata faktike, gjë që konfirmohet plotësisht nga deklarata noteriale e shtetases E.Xh nr. *** rep dhe nr. *** kol, datë 6.7.2020, të cilën e ka dërguar së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr.2.*

-Nuk mendon se qëllimi i ligjit është të merret me gabimet formale-juridike që mund të ketë bërë ai si subjekt në deklarinet periodike apo dokumentet e nënshkruara në mirëbesim, por në gjykimin e tij, qëllimi i ligjit është të verifikojë situatën faktike, nëse subjekti ka fshehur apo jo pasurinë, është krijuar kjo pasuri si rezultat i burimeve të ligjshme, pavarësisht nëse ka bërë ndonjë lapsus në deklarinet.”

27.3. Për sa më sipër, subjekti kundërshton faktin e përfshirjes së kryerjes së pagesës për blerjen e kësaj pasurie në analizën financiare të vitit 2007 dhe kërkon që pas shpjegimeve dhe provave të reja të paraqitura prej tij, pagesa e shumës prej 50,000 eurosh të përfshihet në analizën financiare të vitit 2008 dhe pagesa e shumës prej 10,000 eurosh të përfshihet në analizën financiare të vitit 2011. Subjekti ka referuar si prova të reja 2 mandatpagesa, të konstatuara si më sipër: (i) mandatpagesa prej 50,000 eurosh në vitin 2008, dhe mandatpagesa prej 10,000 eurosh në vitin 2011, të cilat sipas tij provojnë momentin e kryerjes së pagesave ndaj palës shitëse, znj. E.Xh.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

28. Referuar nenit 4, germa “a” e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”, i ndryshuar, subjektet detyrohen të deklarojnë pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, si edhe burimin e krijimit të tyre. Në këtë kuptim, në formularin e deklarin të pasurisë, në seksionin e ndryshimeve të interesave privatë, pasuri të

paluajtshme dhe të luajtshme, në DIP/2007, kërkohet nga deklaruesit që të pasqyrojnë ndryshimet (shtesa dhe pakësime), të ndodhura në interesat pasurorë privatë të deklaruar më parë, për çdo lloj pasurie, të luajtshme dhe të paluajtshme, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit.

28.1. Gjithashtu, bazuar në nenit 4, germa “dh” të ligjit të mësipërme, subjektet detyrohen të deklarojnë detyrimet financiare ndaj personave juridike dhe fizike, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj. Në kuptim të këtij detyrimi ligjor, në formularin e deklarimit të pasurisë, në seksionin e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, në DIP/2007, kërkohet nga deklaruesit që të pasqyrojnë detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë që ekzistojnë brenda dhe jashtë vendit, të mbetura të pashlyera për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit, si edhe detyrimet gjatë vitit të deklarimit.

28.2. Komisioni vlerëson se, edhe në rast të pranimit të pretendimit të subjektit se arsyeja e mosdeklarimit të kësaj pasurie në DIP/2007 ka qenë për faktin e moskryerjes së pagesave gjatë vitit 2007 për blerjen e saj, për sa kohë vetë subjekti ka vetëdeklaruar gjatë hetimit administrativ se ka filluar të banojë në këtë apartament që në shtator të vitit 2007, rezulton se në kundërshtim me parashikimet bëra në ligjin për deklarimin e pasurive, ai nuk e ka deklaruar këtë pasuri në formularin e vitit 2007.

28.3. Për më tepër, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIP/2007 detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë. Në këtë këndvështrim, deklarata e interesave privatë/periodikë e vitit 2007 vlerësohet si provë e rëndësishme nga Komisioni, sipas parashikimit të bërë në nenin 32/5 të ligjit nr. 84/2016.

28.4. Nga ana tjetër, Komisioni çmon se në deklaratat e interesave privatë/periodikë, subjekti ka pasur/ka detyrimin të deklarojë edhe shoqërinë/shoqëritë apo individët me të cilët ka hyrë në marrëdhënie kontraktuale, kjo në kuptim edhe të verifikimeve që mund të bëhen në përputhje me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

28.5. Në vijim të arsyetimit ligjor, Komisioni sjell në vëmendje se referuar nenit 659 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, *kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike*. Neni 660 i Kodit Civil parashikon se *palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi*.

28.6. Neni 663 i Kodit Civil përcakton kushtet e nevojshme për lidhjen dhe vlefshmërinë e kontratës, të cilat janë: *“Pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin; shkaku i ligjshëm në të cilin mbështetet detyrimi; objekti që formon lëndën e kontratës dhe forma e saj e kërkuar nga ligji”*.

28.7. Ndërsa në nenin 690 të Kodit Civil përcaktohet se: *“Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të priset ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjelltë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj”*.

28.8. Në zbatim të dispozitave të mësipërme dhe analizimit të tyre në harmoni me provat e administruara në dosjen e hetimit administrativ lidhur me pasurinë objekt vlerësimi, trupi gjykues vlerëson se nuk ekziston asnjë shkak ligjor që të vërë në dyshim vërtetësinë e fakteve të përshkruara në kontratën e porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.3.2007.

28.9. Trupi gjykues çmon se janë të karakterit deklarativ dhe të pambështetura në ligj e prova pretendimet e subjektit të rivlerësimit për moskryerjen e pagesës së plotë në shumën prej 60,000 euro, gjatë vitit 2007, për porositjen e pasurisë objekt vlerësimi.

28.10. Parë kjo në dritën e mospërputhjeve të konstatuara, si edhe deklarimeve kontradiktore për këtë pasuri, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka bërë përpjekje për të fshehur kontratën e porosisë së datës 20.3.2007. Trupi gjykues, arrin në këtë përfundim, pasi, referuar vetëdeklarimeve dhe situatës financiare ai nuk kishte në dispozicion burime nga të ardhura të ligjshme për të justifikuar pagesën e kryer në datën 20.3.2007, në favor të shtetas E.Xh.

28.11. Si konkluzion, trupi gjykues i qëndron konstatimit dhe rezultatit fillestar se, sipas përcaktimit të bërë në kontratën e porosisë, shuma prej 60,000 eurosh është paguar nga subjekti i rivlerësimit në datën 20.3.2007 dhe, si e tillë, do të pasqyrohet në analizën financiare përfundimtare.

Analiza e burimit të krijimit të pasurisë objekt vlerësimi

Të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit të banimit në Bajram Curri

29.1. Në deklaratën fillestare të pasurisë (deklarata e interesave privatë e vitit 2003) subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë e llojit “shtëpi banimi”, me sipërfaqe 90 m², ndodhur në lagjen “****”, Bajram Curri, me vlerë 1.4 milion lekë, përfituar prej statusit si i përndjekur politik dhe se zotëron 50% pjesë takuese të kësaj pasurie. Gjithashtu, konstatohet se në seksionin e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë ka deklaruar kredi për strehim nga Enti Kombëtar i Banesave, në vlerën 1.4 milion lekë.

29.2. I pyetur nga ILDKPKI-ja¹² lidhur me kredinë e deklaruar në deklaratën për herë të parë në vitin 2003 dhe faktin e mosdeklarimit të kësaj kredie dhe shlyerjes së saj në deklaratat e depozituara në vijim, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se¹³ *ajo është thjesht vlera e banesës, por se subjekti nuk ka marrë kredi, përkundrazi e ka përfituar falas, si ish-i përndjekur politik, nga Enti Kombëtar i Banesave në bazë të marrëveshjes me Institutin e ish-të Përndjekurve Politikë.*

29.3. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar (në DIP/2008 dhe në deklaratën “Vetting”) se ardhurat nga shitja e apartamentit në Bajram Curri kanë shërbyer si burim krijimi për pasurinë objekt vlerësimi, apartamentit në Tiranë.

29.4. Me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit “Vetting”, subjekti, ndër të tjera, ka depozituar si dokumentacion provues për shitjen e apartamentit në Bajram Curri (Aneks *** në dosjen e ILDKPKI): (i) kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme¹⁴ të datës 6.11.2008, (ii) certifikatë për vërtetim pronësie, datë lëshimi 6.11.2008 dhe kopje kartelesh pasurie; si dhe (iii) dy vërtetime të lëshuara nga Komuna Fierzë, datë 6.10.2008 dhe datë 6.11.2008.

29.5. Bazuar në certifikatën për vërtetim pronësie, shtetasit K.H.D, H.A.D dhe Sh.Rr.D, figurojnë bashkëpronarë të pasurisë së llojit “apartament”, me sipërfaqe 82 m², ndodhur në lagjen “****”, Bajram Curri, zona kadastrale nr. ***, pasuria nr. ***, volum ***, faqe ***. Rezulton nga kartela e pasurisë se apartamenti ka qenë më parë në pronësi të shtetit. Më pas është përfituar falas dhe është regjistruar në emër të shtetasve të sipërcituar në datën 18.1.2001.

¹² Pyetësor i drejtuar subjektit, përpiluar në datën 5.11.2014, nga inspektori i ILDKPKI-së, znj. Dh.S, pjesë e dokumentacionit të dërguar nga ILDKPKI me shkresën nr.*** prot., datë 1.7.2020.

¹³ Shkresë e datës 16.11.2014, drejtuar ILDKPKI-së, pjesë e dokumentacionit të dërguar nga ILDKPKI me shkresën nr. *** prot., datë 1.7.2020.

¹⁴ Kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.11.2008, redaktuar nga noteri publik, znj. E.L.

29.6. Me anë të vërtetimit të datës 6.10.2008, Komuna Fierzë konfirmon se z. K.H.D në dokumentet e gjendjes civile është i regjistruar me emrin Izet H Dushaj, dhe se këtë vërtetim e lëshon për të vërtetuar se z. Izet H Dushaj është i njëjti person me emrin K.H.D.

29.7. Me anë të vërtetimit të datës 6.11.2008, Komuna Fierzë konfirmon se znj. H.A.D është i njëjti person me emrin H.A.D, e cila është banore e Komunës Fierzë të Rrethit Tropojë, e regjistruar në regjistrin themeltar nr. ***, fleta *** të qytetit Fierzë.

29.8. Referuar kontratës për shitje pasurie të paluajtshme, datë 6.11.2008, rezulton se shtetasit I (K) D, Sh.D dhe H.D, i kanë shitur shtetasit A.G, pasurinë e sipërcituar për shumën 30,000 euro, për të cilën palët kanë deklaruar se janë likuiduar totalisht, para përpilimit të kësaj kontrate, jashtë zyrës noteriale.

29.9. Pas kërkesës së bërë nga Komisioni, ASHK-ja, Zyra Vendore Tropojë,¹⁵ ka dërguar informacion dhe dokumentacionin e plotë (referencën e plotë) lidhur me këtë pasuri, nga verifikimi dhe analizimi i të cilit konstatohet se:

- i. Në datën 4.1.2001, shtetasit K.D dhe Sh.D kanë “blerë”¹⁶/përfitur nga Enti Kombëtar i Banesave, pasurinë e llojit “apartament banimi” me sipërfaqe 82 m², e përbërë nga 56.8 m² sipërfaqe shfrytëzimi dhe 25.2 m² sipërfaqe në pjesën e përbashkët të shkallëve dhe pjesëve të tjera të përbashkëta të pronës. Referuar kontratës së sipërcituar, vlera e apartamentit, ndërtuar/blerë me fonde shtetërore, është 1,647,447.87 lekë, porse përfituesit e kësaj pasurie nuk kanë paguar për blerjen e saj, për shkak të statusit si ish-të përndjekur politikë. Rezulton se çmimi i pasurisë është paguar nga Instituti i ish - të Përndjekurve Politikë, ndërsa referuar kartelës së pasurisë rezulton se në datën 18.1.2001 ky apartament është regjistruar në regjistrat hipotekorë në emër të K.D, H.D dhe Sh.D.
- ii. Në datën 24.10.2011, shtetasit Izet (K) Dushaj, Sh.D (përfaqësuar me prokurë¹⁷ nga R.D) dhe H.D i kanë shitur¹⁸ këtë pasuri shtetasit I.K për vlerën 2,200,000 lekë dhe se në datën 31.10.2011 kjo pasuri është regjistruar në regjistrat hipotekorë në emër të blerësit.
- iii. Nëpërmjet deklaratës noteriale¹⁹ të datës 25.6.2018, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, Sh.D, në cilësinë e palës shitëse, (përfaqësuar me prokurë nga R.D), si edhe shtetasit I dhe N.K, në cilësinë e palës blerëse, kanë deklaruar se kanë zgjidhur (revokuar) kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.10.2011, duke u kthyer në gjendjen e mëparshme. Pala blerëse ka hequr dorë nga e drejta e pronësisë, duke e kthyer pasurinë në emrin e pronarëve të mëparshëm, duke mos pasur pretendime pronësie, si dhe ka pranuar t’i kthehet shumën e blerjes 2,200,000 lekë. Kjo shumë i është kthyer familjes K nga z. R.D, përfaqësues me prokurë i palës shitëse, Izet dhe Sh.D. Rezulton se, bazuar në deklaratën noteriale të referuar si më sipër, në datën 26.6.2018, kjo pasuri është regjistruar në regjistrat hipotekorë të ASHK-së, Zyrës Vendore Tropojë, në emër të Izet H Dushaj, Sh.Rr.D dhe H.A.D (e cila kishte ndërruar jetë).
- iv. Në vijim rezulton se në datën 27.6.2018 në Zyrën Vendore të ASHK-së Tropojë është aplikuar kontrata e shitjes e datës 6.11.2008 dhe se, po në këtë datë, kjo pasuri është regjistruar në emër të shtetasit A.Rr.G.

29.10. Gjithashtu konstatohet se në datën 27.6.2018, në funksion të aplikimit të kontratës së shitblerjes së datës 6.11.2008, është paguar tatimi për kalimin e pronësisë në shumën

¹⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 20.8.2019.

¹⁶ Kontratë shitjeje apartamenti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.1.2001.

¹⁷ Prokura e posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.10.2011, redaktuar nga noteri publik R.H.

¹⁸ Kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme, me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.10.2011, redaktuar nga noteri publik, znj. E.L.

¹⁹ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.6.2018, redaktuar nga noteri publik, z. I.H.

311,083 lekë, me përshkrimin “A.G tatim mbi kalimin e pronës” dhe gjoba të sistemit për aplikim të vonuar të kontratës – shuma prej 300,200 lekësh, me përshkrimin “A.G ***, Zyrat e Regjistrimit *** Gjoba të sistemit të r.” shuma këto të paguara në favor të ZVRPP-së Tropojë nga shtetasi R.Rr.G.

29.11. I pyetur nga Komisioni lidhur me këto transaksione²⁰, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se në vitin 2008 i kanë shitur shtetasit A.G pasurinë e mësipërme, për shumën 30,000 euro, kontrata e së cilës, për neglizhencë, nuk ishte regjistruar në ZRPP. Më vonë ka rënë në dijeni se përfaqësuesi i tyre me prokurë, z. R.D, i autorizuar për lidhjen e kontratë së shitjes me z. G ka lidhur në mënyrë fiktive një kontratë shitjeje me shtetasin I.K që kishte një marrëveshje me z.A.G. Këta shtetas, me sa duket, këto veprime i kanë kryer për të shmangur penalitetet në Zyrën e Regjistrimit. Në vitin 2018, pasi ka rënë në dijeni të këtij fakti, subjekti i rivlerësimit ka revokuar kontratën si rruga më e mirë dhe në ZRPP është regjistruar kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., me palë blerësin shtetasin A.G, duke paguar të gjitha penalitetet për vonesën në regjistrim.

29.12. Lidhur me pagesën, subjekti ka sqaruar se nga z. A.G ka marrë në vitin 2008 shumën prej 30, 000 eurosh cash, të cilën nuk ia ka kthyer ndonjëherë, pasi nuk ka qenë në dijeni të veprimeve fiktive që ka bërë përfaqësuesi me prokurë. Po kështu, kontrata me nr *** rep., nr. *** kol., është veprim juridik fiktiv i kryer nga përfaqësuesi, për rrjedhojë subjekti nuk ka marrë asnjëherë shumën prej 2,200,000 lekësh. Sërish, sapo është vënë në dijeni, ka kërkuar revokimin e këtij akti.

29.13. Subjekti deklaroi se në lidhje me pjesën takuese sqaron se prej tyre është marrë e gjithë shuma, pasi e ndjera, nëna e tij, duke qenë se po blenin shtëpi të re nuk pranoi të merrte asgjë nga çmimi i shitjes së këtij apartamenti dhe se në lidhje me pagimin e detyrimit tatimor, nuk ka pasur asnjë pretendim nga asnjë organ shtetëror për këtë qëllim.

29.14. Pas vlerësimit të provave të administruara në dosje, në përputhje me arsyetimin ligjor dhe konkluzionin përfundimtar të arritur lidhur me momentin e kryerjes së pagesës së shumës prej 60,000 eurosh për blerjen e apartamentit në Tiranë, si edhe nga verifikimi i transaksioneve të kryera për këtë pasuri, Komisioni vlerëson se të ardhurat nga shitja e pretenduar e apartamentit në Bajram Curri në vitin 2008 nuk mund të kenë shërbyer si burim krijimi për shlyerjen e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi.

29.15. Për më tepër, nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat e pretenduara, si të përfituara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si rrjedhojë e shitjes së këtij apartamenti në vitin 2008. Gjithashtu, nga hetimi i kryer, Komisioni ngre dyshime të arsyeshme mbi fiktivitetin e kontratës së shitblerjes së vitit 2008, kjo pasi:

- i. Kontrata nuk është regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;
- ii. Çmimi i shitjes së këtij apartamenti në vitin 2008 (konvertuar në shumën prej rreth 3,700,000 lekë) nuk i përgjigjet çmimeve të tregut të kohës, pasi referuar Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 20.8.2008, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2008” dhe tabelës nr. 2, aneksi i këtij udhëzimi, “Të dhënat e tregut të lirë të apartamenteve sipas qyteteve për vitin 2008”, për qytetin e Tropojës, vlera mesatare e shitjes lekë/m² për sipërfaqe shfrytëzimi, paraqitet në shumën 22,500 lekë. I përllogaritur, sipas këtij udhëzimi, për apartamentin 82 m², çmimi i shitjes ka qenë 1,845,000 lekë.

²⁰ Pyetja nr. 2 e pyetësorit nr. 2.

- iii. Në vitin 2011 kjo pasuri i është shitur shtetasit I.K në vlerën 2,200,000 lekë, e cila është regjistruar në regjistrat hipotekorë në datën 31.10.2011 në emrin e tij;
- iv. Rezultoi nga prokura e posaçme e datës 21.10.2011 se përfaqësuesit, z. R.D, i janë dhënë tagra të plota përfaqësimi, përfshirë edhe lidhjen e kontratës së shitblerjes. Në këtë kuptim, bazuar në pretendimet e subjektit për shitjen e pasurisë në vitin 2008, rezulton se subjekti me dijeni të plotë ka autorizuar vëllain e tij për shitjen e saj në vitin 2011.
- v. Subjekti ka dhënë shpjegime kontradiktore dhe në mungesë të lidhjes logjike për transaksionet e kryera ndër vite lidhur me këtë pasuri, kjo pasi: **a)** subjekti pretendon se e ka lëshuar prokurën e posaçme pas kërkesës së bërë nga blerësi, A.G, i cili kërkonte të regjistronte pasurinë në emrin e tij, ndërkohë që do të mjaftonte regjistrimi i kontratës së shitblerjes së vitit 2008 në zyrën hipotekore dhe, pas pagesës së detyimeve përkatëse, pasuria do regjistrohej në emër të tij; **b)** subjekti pretendon se këto veprime, duke referuar shitjen e pasurisë shtetasit I.K (veprime të pretenduara si fiktive - të kryera nga vëllai i tij) janë bërë për të shmangur penalitetet për regjistrimin e kontratës së parë të shitjes, pasi në atë kohë A.G kishte hyrë në bisedime me familjen K për shitjen e këtij apartamenti. Nga ana tjetër rezulton se, pas nënshkrimit të deklaratës noteriale të datës 25.6.2018 për prishjen e kontratës së shitblerjes së vitit 2011, regjistrimit sërish të kësaj pasurie në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të, e në vijim aplikimit të kontratës së vitit 2008, kjo pasuri të paktën deri në muajin gusht të vitit 2019, rezulton e regjistruar në emër të shtetasit A.G. Për më tepër, veprimet e kryera në vitin 2018 nga Zyra Vendore e ASHK-së Tropojë vijnë në kundërshtim me ligjin, pasi në kushtet kur një nga bashkëpronarët e kësaj pasurie, znj. H/H Dushaj, kishte ndërruar jetë, nuk mund të aplikohet deklarata noteriale dhe të regjistrohej kjo pasuri edhe në emër të saj e në vijim të regjistrohej kontrata e shitblerjes së vitit 2008; **c)** me deklaratën noteriale të datës 25.6.2018, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, në cilësinë e palës shitëse, (përfaqësuar me prokurë nga R.D), si edhe shtetasit I.K dhe N.K, në cilësinë e palës blerëse, deklarojnë se kanë zgjidhur (revokuar) kontratën e datës 24.10.2011, duke u kthyer në gjendjen e mëparshme. Në këtë kuptim, duket fakt i pranuar shitja e kësaj pasurie familjes K në vitin 2011.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

30. Pasi Komisioni i kaloi barrën e provës për të dhënë argumentet dhe provat e tij në lidhje me konstatimet e mësipërme, me dërgimin e prapësimeve, subjekti u ka qëndruar shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur se:

30.1. *Së pari, në vitin 2007 nuk ka bërë asnjë pagesë dhe pagesa për blerjen e apartamentit në Tiranë është bërë në vitin 2008, në shumën prej 50,000 euro, ndërsa pjesa tjetër prej 10,000 eurosh është bërë në vitin 2011.*

30.2. *Së dyti, në lidhje me mospagesën e tatimeve në vitin 2008, kjo ka ardhur për shkak të neglizhencës së palës blerëse për regjistrimin e kontratës në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në atë vit.*

30.3. *Së treti, në lidhje me dyshimet e ngritura për fiktivitetin e kontratës së shitblerjes së apartamentit në vitin 2008, rikujton se ky apartament është përfituar falas si ish- i përndjekur politik. Nga ana tjetër parashtron se, nga pikëpamja ligjore blerësi bëhet pronar i apartamentit në momentin e lidhjes së kontratës dhe jo në momentin e regjistrimit të saj në regjistrat e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të paluajtshme, duke referuar vendimin unifikues të datës 6.1. 2009, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.*

30.4. *Së fundmi, në lidhje me çmimin e shitjes së shtëpisë në Bajram Curri në vlerën 30,000 euro, subjekti ka parashtruar se në dijeninë e tij nuk ka ndonjë ligj që pengon lirinë kontraktore apo që përcakton çmimet e shitjes së pasurive të paluajtshme jashtë vullnetit të dakordësuar të palëve në kontratë. Ndërsa, në lidhje me prokurën, pretendon se ia ka dhënë vëllait, me qëllim përmbylljen e veprimeve për shitjen e apartamentit, por jo për të kryer veprime fiktive. Në kryerjen e këtij veprimi nuk është thelluar në analizën ligjore, nëse lëshimi i prokurës ishte i nevojshëm apo jo, duke menduar se ishte një procedurë burokratike që kërkohej nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.*

30.5. Subjekti ka pranuar se në deklaratimet e tij ndër vite mund të ketë lapsuse apo pasaktësi, por në asnjë mënyrë nuk mund të pranojë që ka veprime të simuluar apo fshehje pasurie.

Vlerësimi i Komisionit

31. Trupi gjykues, vlen të ritheksojë se i qëndron konkluzionit se pagesa për blerjen e pasurisë është bërë në vitin 2007 dhe, në këtë kuptim, të ardhurat e pretenduara nga shitja e apartamentit në vitin 2008 nuk mund të kenë shërbyer si burim krijimi për blerjen e apartamentit.

31.1. Nga ana tjetër, pasi vlerësoi me objektivitet prapësimet e subjektit të rivlerësimit, duke i ballafaquar dhe analizuar ato me provat shkresore të administruara në dosjen e hetimit administrativ dhe transaksionet e kryera për këtë pasuri, trupi gjykues çmon se subjekti nuk ishte bindës në shpjegimet e tij dhe, në këtë kuptim, ngre dyshime të arsyeshme se transaksioni i vitit 2008 është veprim i simuluar, me qëllim në dukje justifikimin e burimit të të ardhurave për pagesën e deklaruar nga subjekti gjatë këtij viti për shlyerjen e çmimit të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi.

Shuma prej 5,000 paundësh, deklaruar si e dhuruar nga vëllai i tij, z. E.D

32. Konstatohet se në DIP/2007 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje *cash* në banesë, vlerën prej 5,000 paund, dërguar nga vëllai nga Anglia, por nuk ka deklaruar identitetin e personit prej nga ka ardhur dhurimi, gjë që vjen në kundërshtim me germën “F”, të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar,

32.1. I pyetur nga ILDKPKI-ja²¹ lidhur deklarimin e bërë në DIP/2007 për gjendjen *cash* në shumën prej 5,000 paund, si shumë dërguar nga vëllai nga Anglia, duke i kërkuar sqarime mbi mënyrën e dërgesës së kësaj shume, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se²² *vëllai i tij E.D, i cili jeton në Londër që nga viti 1998, familjarisht, i ka dhënë këtë shumë parash si ndihmë për blerjen e shtesës së apartamentit, në kohën kur vetë subjekti ka qenë në Angli me shërbim me disa gjyqtarë dhe Këshillin e Lartë të Drejtësisë.*

32.2. Referuar të dhënave të sistemit *TIMS*²³, rezulton se gjatë vitit 2007 subjekti i rivlerësimit ka dalë 3 (tri) herë jashtë shtetit shqiptar dhe daljet janë bërë në datat dhe pikat kufitare si vijon: (i) në datën 1.6.2007, dalje nga Porti i Durrësit; (ii) në datën 28.6.2007, dalje nga pika kufitare e Qafë Thanës; dhe (iii) në datën 5.10.2007, dalje nga pika kufitare e Tusheshimitit.

32.3. Me dërgimin e rezultateve të hetimit Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit se cila nga këto dalje jashtë shtetit shqiptar ka pasur si destinacion final shtetin anglez, si

²¹ Pyetësor i drejtuar subjektit, përpiluar në datën 5.11.2014, nga inspektori I ILDKPKI, znj. Dh.S, pjesë e dokumentacionit të dërguar nga ILDKPKI me shkresën nr.*** prot., datë 1.7.2020.

²² Shkresa e datës 16.11.2014 drejtuar ILDKPKI-së, pjesë e dokumentacionit të dërguar nga ILDKPKI me shkresën nr.*** prot., datë 1.7.2020.

²³ Dërguar me shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me shkresën nr. *** prot., datë 19.7.2019.

edhe të shpjegonte itinerarin e ndjekur të udhëtimit (vajtje-ardhje). Gjithashtu, Komisioni kërkoi nga subjekti depozitimin e dokumentacionit justifikues ligjor për të provuar deklaratimet e tij të bëra në ILDKPKI, se udhëtimi në shtetin anglez ka qenë për arsye shërbimi.

32.4. Nëpërmjet prapësimeve të dërguara, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se *nuk u ka kushtuar rëndësinë e duhur pyetjeve të ILDKPKI-së, duke deklaruar se i ka marrë vetë këto para në Londër. E vërteta është se, në daljen e tij jashtë shtetit më 1 qershor 2007 me anëtarët e KLD-së ka pasur si destinacion Spanjën. Pasi ka rënë në dijeni se i vëllai gjendej për një festë familjare te motra, në Bruksel, subjekti është shkëputur dy ditë nga vizita zyrtare dhe ka shkuar në Bruksel te motra, ku edhe i është dhënë shuma e parave.*

32.5. Në mbështetje të deklaratimeve të tij, subjekti ka depozituar si provë të re shkresën e KLGJ-së me nr. *** prot., datë 23.8.2021, nga verifikimi i të cilës konfirmohet se subjekti i rivlerësimit ka marrë pjesë në një vizitë pune në Mbretërinë e Spanjës për periudhën 1-20 qershor 2007, në kuadër të një projekti ndërmjet ish-KLD-së dhe Agjencisë Spanjolle për Bashkëpunimin Ndërkombëtar në Rajonin e Ballkanit.

32.6. Sa më sipër, bazuar në pikën 14 të nenit 3, si dhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, shtetasi E.D, bën pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, në këtë rast bazuar në parimin e proporcionalitetit të provojë ligjshmërinë e burimit të të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumës prej 5,000 paund, pretenduar si të dhuruar në favor të subjektit të rivlerësimit në vitin 2007.

32.7. Siç u konstatua më sipër, në deklaratën “Vetting”, si një nga burimet e krijimit të pasurisë objekt vlerësimi, subjekti ka deklaruar shumën 5,000 paund, e cila i është dhuruar nga vëllai E.D, në bazë të deklaratës noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.3.2015. Subjekti ka depozituar (Aneks *** në dosjen e ILDKPKI-së) deklaratën noteriale të sipërcituar.

32.8. I pyetur nga Komisioni lidhur me dhurimet²⁴ me vlerë mbi 500 euro, duke i kërkuar të specifikojë burimin e shumës së dhuruar, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se, *siç ka pasqyruar edhe në deklaratën vetting, ka marrë dhuratë në vlerë 5,000 paund në vitin 2014 nga vëllai i tij E.D, i cili është emigrant në Angli prej vitit 1998, familjarisht, me dokumente të rregullta, gjë të cilën e ka konfirmuar edhe ai vetë nëpërmjet deklaratës noteriale të datës 23.3.2015, me nr. *** rep., nr. *** kol, (depozituar pranë ILDKPKI-së me dorëzimin e deklaratës “Vetting”).*

32.9. Referuar deklaratës noteriale të datës 23.3.2015, deklaruesi E.H.D, i datëlindjes 7.1.1961, lindur në D e me banim në Angli, ka deklaruar se çdo vit i dhuron vëllait të tij Izet Dushaj (lindur në Tropojë) shumën prej 5,000 paund.

Gjithashtu dhe në vitin 2014 i ka dhuruar shumën prej 5,000 paund. Këtë dhurim të kësaj shume e bën për raste si festa, ditëlindje, mbulime shpenzimesh të tjera familjare, nga të ardhurat e tij, pasi ka 17 vite që jeton dhe punon me tre fëmijët e tij në Angli.

32.10. I pyetur sërish nga Komisioni²⁵, duke i kërkuar të deklarojë gjeneralitetet e vëllait të tij si edhe të depozitujë dokumentacion justifikues ligjor për burimin e të ardhurave të personit tjetër të lidhur, të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumës së dhuruar, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *gjeneralitetet e vëllait të tij janë E.D, i biri i H dhe i H, datëlindja 7.6.1961. Në lidhje me këto të ardhura në kohën kur ka marr vesh se ai vetë*

²⁴ Pyetësori nr. 1 (standard), pyetja nr. 2.

²⁵ Pyetja nr. 3 e pyetësorit nr. 2.

po blinte shtëpi, vëllai i ka marrë borxh shtetases angleze M.J.C në tetor të vitit 2005. Në vijim subjekti ka deklaruar se ai nuk e dinte se vëllai i tij i ka marrë borxh këto para.

32.11. Në mbështetje të deklaramit të tij, subjekti ka depozituar deklaratën e shtetases angleze M.J.C, të datës 31.10.2019. Referuar këtij dokumenti²⁶, znj. C ka deklaruar se në datën 30 tetor 2005 i ka dhënë z. E.H.D, një shtetasi shqiptar, një hua, pa ndonjë afat kohor si kthim, në shumën 5,000 paund, dhe se zoti D kishte nevojë për këtë shumë për nevoja të familjes së tij, duke konfirmuar se kjo shumë është e saj dhe se burimi i shumës janë kursimet nga punësimi i saj. Në vijim ajo ka deklaruar se banka nuk mund të japë dëshmi me të dhëna për shumën, si për shembull deklarata lidhur me llogarinë, pasi mund të japë një dokument të tillë vetëm për një periudhë 5-vjeçare.

32.12. Në vlerësim të pretendimeve të konstatuara si më sipër, Komisioni ngre dyshime të arsyeshme lidhur me deklaramin e bërë për burimin e të ardhurave të shumës prej 5,000 paundësh, të mbështetura nga deklarata e shtetases angleze, kjo pasi nuk ka logjikë ekonomike që z. E.D të marrë një borxh në vitin 2005, me qëllimin dhurimin e kësaj shumë vëllait të tij në vitin 2007.

32.13. Ndërsa, i pyetur²⁷ mbi deklarimet e bëra nga vëllai i tij në deklaratën noteriale të datës 23.3.2015, duke i kërkuar të konfirmojë sa është shuma totale e dhuruar prej tij, për periudhën, vlerën dhe mënyrën (*cash* apo nëpërmjet bankës) të dorëzimit të shumave të dhuruara, si edhe të shpjegonte se përse nuk janë deklaruar prej tij këto shuma të dhuruara, subjekti i rivlerësimit deklaroi se *është e vërtetë se vëllai i tij ka bërë një deklaratë në vitin 2014 ku thotë se çdo vit i dhuron vëllait të tij 5,000 paund, por në fakt një gjë e tillë ka ndodhur vetëm një herë në vitin 2007, gjë të cilën e ka deklaruar në deklaramin periodik. Sa i përket viteve të tjera, kjo gjë nuk ka ndodhur. Nëse kjo do të kishte ndodhur, do ta kishte deklaruar, pasi ky shtim të ardhurash do të ishte në favorin e tij, për efekt të deklaramit të pasurisë, pasi do të shtonte në mënyrë të ndjeshme të ardhurat e tij ndër vite, por një dhuratë e tillë ka ndodhur vetëm në kohën kur ai po blinte shtëpi dhe e ka deklaruar. Është e vërtetë se çdo vit vëllai u ka bërë dhurata fëmijëve, por këto dhurata kanë qenë në vlera të vogla dhe nuk kanë qenë asnjëherë në kufijtë e vlerave të detyrueshme për deklarim dhe asnjëherë, as veç e veç, as të gjitha bashkë, nuk e kanë kapur shumën e 300,000 lekëve të reja në vit.*

32.14. Për sa më sipër, nga analizimi në tërësi i deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit, si edhe i dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit administrativ, lidhur me këtë marrëdhënie dhurimi, rezulton se:

- i. Subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të provuar të ardhurat të personit tjetër të lidhur, të cilat kanë shërbyer për dhurimin e pretenduar në vitin 2007.
- ii. Në kushtet kur, në referim të kontratës së sipërmarrjes së datës 20.3.2007, parashikohet se pagesa e çmimit prej 60,000 eurosh është kryer me nënshkrimin e saj dhe se subjekti e ka deklaruar si shtesë likuiditetesh *cash* gjatë vitit 2007, shumën prej 5,000 paundësh të pretenduar si të dhuruar nga vëllai i tij, z. E.D, rezulton se gjithsesi kjo shumë nuk mund të ketë shërbyer si burim krijimi për pasurinë objekt vlerësimi.
- iii. Ka deklarime kontradiktore nga subjekti i rivlerësimit dhe personi tjetër i lidhur me këtë marrëdhënie dhurimi, kjo pasi: (a) në DIP/2007, në deklaratën “Vetting” dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi se vëllai i tij i ka dhuruar shumën 5,000 paund në vitin 2007, ndërsa në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se ka marrë dhuratë në vlerë 5,000 paund në vitin 2014 nga vëllai i

²⁶ Të përkthyer nga përkthyesja S.D, konfirmuar firma e përkthyeses me vërtetim nënshkrimi nr. *** rep., datë 27.1.2020, të redaktuar nga noteri publik, znj. A.Ç.

²⁷ Pyetja nr. 4 e pyetësorit nr. 2.

tij E.D; **(b)** Personi tjetër i lidhur, nëpërmjet deklaratës noteriale të datës 23.3.2015, ka deklaruar se çdo vit i dhuron vëllait të tij, Izet Dushaj, shumën 5,000 paund, të cilën ia ka dhuruar gjithashtu edhe në vitin 2014. Ndërkohë, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar vëllai i tij ka bërë një deklaratë në vitin 2014 ku thotë se çdo vit i dhuron vëllait të tij 5,000 paund, por në fakt një gjë e tillë ka ndodhur vetëm një herë në vitin 2007; **(c)** ka ndryshim të deklarimeve lidhur me burimin e krijimit të të ardhurave të personit tjetër të lidhur për krijimin e shumës prej 5,000 paundësh; **(d)** në deklaratimet e dhëna në ILDKPKI, në nëntor të vitit 2014, subjekti ka deklaruar se kjo shumë i është dhënë si ndihmë për blerjen e shtesës, për të cilën pretendon (sipas deklaratimit të bërë në DIP 2011) se e ka marrë në përdorim në vitin 2011 dhe po në atë vit ka kryer pagesën përkatëse. Ndërkohë, në DIP/2008 ka deklaruar se kjo shumë ka shërbyer si burim për kryerjen e pagesës në shumën prej 50,000 euro gjatë këtij viti, për apartamentin me sipërfaqe 98 m².

32.15. Pasi Komisioni i kaloi barrën e provës, krahas qëndrimit të përsëritur se pagesa e kështit të parë për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi është kryer në vitin 2008, lidhur me burimin e krijimit të shumës 5,000 paund dhuruar nga vëllai, subjekti u ka qëndruar deklarimeve të dhënë gjatë hetimit administrativ, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur se *kjo nuk është një marrëdhënie biznesi, por është një marrëdhënie familjare dhe vëllai i tij pa i treguar se i ka marrë borxh, ia ka dhënë këtë shumë, me qëllim për ta ndihmuar për të blerë shtëpinë. Kjo ka ardhur për shkak të lidhjes së tyre si vëllezër dhe jo për interesa ekonomike*²⁸.

Vlerësimi i Komisionit

33. Trupi gjykues, bazuar në analizën e provave dhe arsyetimin ligjor të kryer si më sipër, i qëndron konkluzionit se pagesa për blerjen e apartamentit është bërë në vitin 2007 dhe, në këtë kuptim, të ardhurat e pretenduara si të dhuruara nga vëllai subjektit gjatë vitit 2007, deklaruar si pasuri në formë likuiditetesh gjendje *cash* në fund të vitit 2007, nuk mund të kenë shërbyer si burim krijimi për pasurinë objekt vlerësimi.

33.1. Gjithsesi, për një hetim sa më të plotë, të gjithanshëm dhe shterues Komisioni vlerësoi të shqyrtojë këtë marrëdhënie dhurimi, duke verifikuar dhe analizuar vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti dhe ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të palës dhuruese, në kuptim të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016.

33.2. Komisioni vëren se subjekti në vazhdimësi ka dhënë deklaratime kontradiktore lidhur me këtë marrëdhënie dhurimi, e konkretisht mbi periudhën e marrjes së kësaj shume, lidhur me destinacion dhe për mënyrën e marrjes së saj, si dhe vendin ku e ka marrë. Gjithashtu, konstatohet se gjatë hetimit administrativ subjekti ka ndryshuar deklaratimet e tij lidhur me të ardhurat e dhuruesit, të cilat kanë shërbyer si burim krijimi të shumës së dhuruar.

33.3. Vlen të theksohet fakti se, krahas deklarimeve kontradiktore të konstatuara me rezultatet e hetimit administrativ, me dërgimin e prapësimeve, subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar deklaratimet e tij lidhur me vendin e marrjes së kësaj shume. Megjithatë, subjekti nuk arriti të provonte faktin e udhëtimit dhe qëndrimit të tij dhe të personit tjetër të lidhur në Belgjikë, për periudhën kur pretendohet se është marrë kjo shumë.

²⁸ Subjekti ka depozituar deklaratën e shtetases angleze M.J.C, datë 23 gusht 2021, në formën e kërkuar nga ligji (me vulë apostile), të përkthyer në gjuhën shqipe, konfirmuar me vërtetim përkthimi nr. *** rep, datë 30.8.2021, redaktuar nga noteri publik, znj. A.Ç.

33.4. Për më tepër, rezulton se subjekti nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e palës dhuruese, vëllai të tij, qoftë edhe për të ardhurat e pretenduara si të dhëna hua nga shtetasja angleze. Dokumentacioni i depozituar nga subjekti, deklarata e shtetases angleze, referon vetëm faktin se kjo shtetase i ka dhënë hua në tetor të vitit 2005, shumën prej 5,000 paundësh, shtetasit E.D, por, konstatohet se subjekti nuk ka depozituar dokumentacion justifikues për të provuar ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të shtetases angleze.

33.5. Si përfundim, pasi vlerësoi me objektivitet shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe analizoi provat e administruara në dosje, trupi gjykues i qëndron konstatimit dhe rezultatit fillestar mbi deklaratimet kontradiktore lidhur me këtë marrëdhënie huaje, se nuk ka logjikë ekonomike pretendimi i bërë nga personi tjetër i lidhur/subjekti për origjinën e burimit të shumës së dhuruar, si edhe se nuk u arrit të provohej me dokumentacion justifikues ligjshmëria e burimit të të ardhurave të huadhënësit.

Kursimet ndër vite të deklaruara më parë

34. Siç u konstatua më sipër, subjekti ka deklaruar se ka kryer pagesën në shumën prej 50,000 eurosh në vitin 2008 dhe se një nga burimet e krijimit është pakësimi i gjendjes *cash* të deklaruar për vitet 2005, 2006, 2007, dhe një pjesë nga kursimet e vitit 2008. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se në vitin 2011, ka kryer pagesën në shumën prej 10,000 eurosh, me burim krijimi pakësimin e gjendjes *cash* dhe të ardhurat nga pagat.

34.1. Nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë periodike/vjetore të depozituara nga subjekti ndër vite në ILDKPKI konstatohet se: (i) në DIP/2005 subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 300,000 lekë, (ii) në DIP/2006 subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në banesë, shtuar 300,000 lekë; (iii) në DIP/2007, krahas deklaratimit të gjendjes *cash* në valutë në shumën 5,000 paund, dhuruar nga vëllai (analizuar si më sipër), ka deklaruar gjendje *cash* në banesë, kursime për vitin 2007, shtuar 500,000 lekë; (iv) në DIP/2009 ka deklaruar shtesë të gjendjes *cash* në banesë për vitin 2009, shumën prej 400,000 lekë, me burim krijimi të ardhurat nga pagat; dhe (v) në DIP/2010 ka deklaruar shtesë të gjendjes *cash* në banesë për vitin 2010, shumën 600,000 lekë, me burim krijimi të ardhurat nga pagat.

34.2. Në deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, si edhe gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni, subjekti ka pretenduar se vlerat e deklaruar *cash* për vitet 2005, 2006, 2007, si edhe kursimet nga të ardhurat nga pagat për vitin 2008, kanë shërbyer si burim krijimi për pagesën e kryer në shumën prej 50,000 eurosh gjatë vitit 2008, për pasurinë objekt vlerësimi. Ndërsa, shumat e deklaruara *cash* për vitet 2009 – 2010 dhe të ardhurat nga pagat kanë shërbyer si burim për pagesën e kryer në vitin 2011, në shumën prej 10,000 eurosh.

34.3. Në kushtet kur, në referim të kontratës së sipërmarrjes së datës 20.3.2007, parashikohet se pagesa e çmimit prej 60,000 eurosh është kryer me nënshkrimin e saj, rrethanë për të cilën Komisioni ka vlerësuar provat dhe ka kryer arsyetimin e tij, duke mbajtur qëndrim përfundimtar, si edhe nisur nga fakti se subjekti nuk ka deklaruar pakësimin e kursimeve *cash* për vitet 2005 dhe 2006, trupi gjykues vlerëson se kursimet e deklaruara në formë likuiditetesh *cash* në lekë për vitet 2005, 2006, 2007, si edhe kursimet nga të ardhurat e përfituara gjatë vitit 2008, nuk mund të kenë shërbyer si burim krijimi për pasurinë objekt vlerësimi. Gjithashtu edhe kursimet në formë likuiditetesh *cash*, të deklaruara për vitet 2009 dhe 2010, nuk mund të kenë shërbyer si burim krijimi të kësaj pasurie.

34.4. Për më tepër, referuar analizës financiare të kryer nga Komisioni, rezulton se vitet 2005, 2007, 2009, 2010 (vite në të cilat subjekti ka deklaruar shtesë likuiditetesh në gjendje cash) paraqiten me balancë negative fondesh²⁹.

34.5. Gjithashtu, nga verifikimi dhe analizimi i dy mandatpagesave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, si prova të reja mbas dërgimit të rezultateve të hetimit, Komisioni vëren se njëra nga mandatpagesat referon të dhënat se pagesa e këstit të dytë në shumën prej 10,000 eurosh, është kryer në datën 7 dhjetor 2011.

34.6. Ndërkohë, rezulton se subjekti në vazhdimësi ka deklaruar se pagesa e këstit të dytë është kryer me nënshkrimin e kontratës së shitjes/hipotekimit, kontratë e cila rezulton se është nënshkruar në datën 3.1.2011.

34.7. Në kushtet kur, referuar vetëdeklarimeve të subjektit, kursimet e deklaruara deri në vitin 2007 janë pakësuar totalisht në vitin 2008 e në vijim, deri në vitin 2010, ka deklaruar shtesa në total likuiditetesh *cash* për shumën prej 1,000,000 lekësh (DIP/2009 dhe DIP/2010), si edhe duke marrë në konsideratë faktin se deri në datën 3 janar 2011, subjekti apo personi i lidhur nuk kanë disponuar të ardhura nga pagat në llogaritë e tyre bankare, trupi gjykues çmon se me ndryshimin e deklarimit, sa i përket pagesës së këstit të dytë, subjekti i rivlerësimit ka bërë përpjekje për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të të ardhurave për pagesën e pretenduar prej tij, si të kryer në vitin 2011, për sa kohë shuma 1,000,000 lekë është më e vogël se shuma 10,000 euro.

34.8. Edhe nga vlerësimi dhe analizimi i pretendimit për momentin e pagesës së këstit të parë, sipas mandatit të kryer në datën 20.11.2008, rezulton se nuk ka logjikë ekonomike që pagesa e parë nga subjekti për këtë pasuri të jetë bërë rreth 18 muaj pas nënshkrimit të kontratës së porosisë ose rreth 13 muaj para marrjes në përdorim të saj (subjekti ka deklaruar se e ka marrë në përdorim apartamentin që në muajin shtator të vitit 2007).

34.9. Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosjen e hetimit administrativ, si edhe verifikimet e kryera lidhur me të ardhurat e deklaruara si burim krijimi të pasurisë objekt vlerësimi (apartamentit në Tiranë), Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë me qëllim verifikimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit për kryerjen e pagesës në shumën prej 60,000 eurosh në datën 20.3.2007 për likuidimin e çmimit të blerjes së kësaj pasurie, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 1.

Analiza financiare për periudhën 1.1.2007 – 20.3.2007	Vlerat në lekë
A) PASURI	7 218 041
Apartament me sipërfaqe 158 m ² në Tiranë, me vlerë 60,000 euro	7 254 600
Ndryshim likuiditeti	-36 559
B) DETYRIME	0
C) PASURI NETO	7 218 041

²⁹ Referohu tabelës së analizës financiare përmblendhëse (ku janë reflektuar disa ndryshime pas kalimit të rezultateve të hetimit – duke u reflektuar disa të ardhura shtesë dhe vlera të dhuruara për të cilat subjekti dha shpjegime bindëse të mbështetura në dokumentacion provues), ndodhur Aneks -1, pjesë e këtij vendimi.

D) TË ARDHURA	273 691
Të ardhura nga paga, subjekti i rivlerësimit	273 691
E) SHPENZIME	192 965
Shpenzime minimale jetese	179 665
Shpenzime udhëtimi brenda vendit për në vendin e punës	13 300
BALANCA E FONDEVE (D-C-E)	- 7 137 315

34.10. Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar likuidimin e çmimit për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” të ligjit nr. 84/2016.

35. Pasuria e llojit “automjet”, i markës “Mercedes – Benz”, blerë në datën 26.7.2016, në vlerën 600,000 lekë. Subjekti deklaroi se zotëron 50% pjesë takuese mbi këtë pasuri.

35.1. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar të ardhurat nga shitja e automjetit të markës “Audi”, tipi “A6”, (blerë në vitin 2012 në shumën 5,000 euro, shitur në datën 7.6.2016 në vlerën 990,000 lekë). Rezulton se kjo pasuri është deklaruar edhe në DPV/2016.

Hetimi/verifikimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri

36. DPSHTRR-ja³⁰, informon se subjekti i rivlerësimit ka të regjistruar në emrin e tij automjet me targë AA***GL, i markës “Daimler Chrysler” (Mercedez Benz), tipi “C220CDI”, vit prodhimi 2007. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga DPSHTRR-ja konfirmohet se subjekti i rivlerësimit e ka blerë³¹ këtë automjet në datën 26.7.2016, për vlerën 600,000 lekë.

36.1. Sa më sipër rezulton se subjekti ka deklaruar saktë të dhënat për këtë pasuri.

Analiza e burimit të krijimit të kësaj pasurie

37. Nga verifikimi i deklaratave peridoke vjetore të interesave privatë të dorëzuar ndër vite në ILDKPKI, rezulton se në DPV/2012 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerjen e pasurisë së llojit “automjet”, të markës “Audi”, në vlerën 5,000 euro, me burim krijimi të ardhurat nga pagat.

37.1. Nga verifikimi i dosjes së këtij mjeti³² rezulton se: i) në datën 14.5.2012, subjekti i rivlerësimit ka blerë³³ automjetin e markës “Audi”, tipi “A6”, me targë CN***LF, vit prodhimi 2005, për vlerën 5,000 euro (konvertuar në shumën prej 698,600 lekë); ii) në datë 24.5.2012 janë kryer procedurat e zhdoganimit të këtij automjeti. Rezulton se ky mjet është deklaruar në vlerën 5,000 euro, por vlera statistikore e tij (referenca) është përcaktuar në shumën 1,536,460 lekë dhe bazuar në këtë vlerë janë paguar detyrimet doganore në shumën 307,291 lekë; (iii) në datën 6.7.2016, subjekti i rivlerësimit e ka shitur³⁴ këtë automjet për vlerën 990,000 lekë.

³⁰ Shkresa nr. *** prot., datë 16.7.2019.

³¹ Kontratë shitje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.7.2016, redaktuar nga noteri publik, z. R.S.

³² Dërguar nga DPSHTRR-ja me shkresën nr. *** prot., datë 16.7.2019.

³³ Kontratë shitjeje pasuri e paluajtshme me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.5.2012, redaktuar nga noteri publik, znj. Xh.B.

³⁴ Kontratë shitblerjeje automjeti me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.7.2016, redaktuar nga noteri publik, z. I.H.

37.2. Sa më sipër, rezulton se vlera e shpenzuar nga subjekti deri në datën 24.5.2012 për blerjen dhe zhdoganimin e këij mjete është në shumën 1,005,891 lekë.

37.3. Referuar vetëdeklarimeve e bëra, si edhe bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiare për periudhën 1.1.2012 – 24.5.2012, nga ku rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht shpenzimet e kryera deri në datën 24 maj të vitit 2012 për blerjen e automjetit të markës “Audi” (balanca negative e fondeve në vlerën 789,045 lekë).

37.4. Komisioni i kaloi barrën e provës subjektivit për të dhënë argumentet/shpjegimet përfundimtare dhe të depozonte prova të reja të mundshme, lidhur me konstatimin e mësipërm, rezultatet e analizës financiare në momentin e blerjes së pasurisë objekt vlerësimi, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektivit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

38. Me dërgimin e prapësimeve, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar rezultatet e analizës paraprake financiare të kryer nga Komisioni në lidhje me blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, duke pretenduar që të reflektohen ndryshimet e mëposhtme:

- i. Llogaritja e të ardhurave nga paga, të përfituara nga bashkëshortja nga data 1.1.2012 - 24.5.2012 të konsiderohen në 50,000 lekë/muaj, aq sa është kredituar në llogari dhe jo paga prej 20,000 lekë, për të cilat është paguar tatimi mbi të ardhurat nga punësimi nga punëdhënësi, duke pretenduar se bashkëshortja nuk ka pasur detyrim për mospagimin e detyrimeve nga punëdhënësi dhe se është detyrim i punëdhënësit për llogaritja, mbajtja dhe pagesa e tatimit dhe kontributeve përkatëse.
- ii. Në muajin maj 2012 një hua nga shtetasi F.C në shumën 400,000 lekë, e cila është shlyer brenda vitit në dhjetor 2012 dhe, për rrjedhojë, s’ka pasur detyrimin për ta deklaruar në DPV/2012.
- iii. Gjithashtu, sipas subjektivit duhet mbajtur parasysh se, shpenzimet e familjes së tij nuk kanë qenë aq sa shpenzimet e llogaritura për efekte statistikore nga ana e Komisionit, pasi në këto shpenzime llogariten një sërë faktorësh si shpenzimet për duhan dhe pije alkoolike, qira etj., shpenzime të cilat familja e subjektivit nuk i ka bërë.

38.1. Në mbështetje të pretendimeve të tij ka depozituar si prova të reja: (i) vërtetim për bazën e vlerësuar për personin e lidhur Sh.D për punësimin në periudhën maj 2010 – dhjetor 2011; (ii) deklaratë noteriale të shtetasis F.C; (iii) vërtetime nga Gjykata e Apelit Durrës se nuk kam pasur çështje gjyqësore civile/penale, me palë ndërgjyqëse /kallëzues /të kallëzuar/ të pandehur të dëmtuar etj., me palë ndërgjyqëse shoqërinë “****” sh.p.k dhe F.C; (iv) kopje të pasqyrave financiare të shoqërisë “****” sh.p.k., që vërtetojnë se burimi i këtyre të ardhurave ka qenë i ligjshëm; dhe (v) kopje të vendimit nr. *** i vendimit (***), datë 17.9.2015, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Vlerësimi i Komisionit

39. Pasi vlerësoi me objektivitet shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe analizoi provat e administruara në dosje, trupi gjykues vlerëson se:

39.1. Lidhur me të ardhurat shtesë të pretenduara nga puna e bashkëshortes, Komisioni konstaton se nga verifikimi i llogarisë bankare të saj në “Raiffeisen Bank” konfirmohet se për këtë periudhë i është kredituar nga punëdhënësi “E.K 2009” sh.a., paga neto në vlerën 50,000 lekë/muaj, e cila është më e lartë se paga e deklaruar për efekt sigurimesh shoqërore dhe shëndetësore.

39.2. Trupi gjykues vëren se, sipas legjislacionit shqiptar, e konkretisht parashikimeve të bëra në: (i) Kodin e Punës, nenet 109, 110, 117, 121; (ii) neni 13 i ligjit nr. 7703/1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; (iii) neni 6 dhe neni 8 i ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në fuqi në kohën kur pretendohet se duhet të ishin derdhur detyrimet për kontributet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore; (iv) ligjin nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; (v) neni 10 i ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar; (vi) udhëzimi nr. 5, datë 30.1.2006 i ministrit të Financave, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, punëdhënësi ka detyrimin dhe përgjegjësinë për pagimin e tatimit dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore për punëmarrësit.

39.3. Për sa më sipër, Komisioni vendosi të rillogarisë të ardhurat e personit tjetër të lidhur për periudhën në fjalë, në përputhje me vlerat e konstatuara si të kredituara në llogari bankare, duke reflektuar ndryshimet përkatëse në analizën financiare.

39.4. Sa i përket pretendimit të subjektit lidhur me huan e marrë në maj 2012 nga shtetasi F.C, Komisioni vëren se pavarësisht se në dukje subjekti nuk ka pasur detyrimin për deklarimin e kësaj huaje në DIP/2012, pretenduar si e marrë dhe e shlyer brenda vitit, në formularin e vitit 2012, subjekti duhet të kishte treguar kujdesin e duhur për ta deklaruar këtë hua si burim krijimi të pasurisë së tij. Vërehet se si burim krijimi i kësaj pasurie, në DIP/2012, janë deklaruar vetëm të ardhurat nga pagat.

Në këtë kuptim, trupi gjykues çmon se nuk mund të pranohet pretendimi i subjektit se për blerjen e kësaj pasurie kanë shërbyer të ardhurat nga shuma e marrë hua prej shtetasit F.C në maj të vitit 2012.

39.5. Ndërsa pretendimet lidhur me reduktimin e shpenzimeve jetike vlerësohen se janë të karakterit deklarativ dhe, për rrjedhojë, Komisioni nuk do të reflektojë ndryshime në analizën financiare sa i përket këtij zëri.

39.6. Sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, si edhe në vlerësim objektiv të shpjegimeve dhe provave të depozituara pas rezultateve të hetimit, Komisioni kreu analizën përfundimtare e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2012 – 24.5.2012, me qëllim verifikimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur për kryerjen e pagesës në shumën 1,005,891 lekë për blerjen dhe zhdoganimin e automjetit të markës “Audi”, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 2.

Analiza financiare për periudhën 1.1.2012 – 24.5.2012	Vlerat në lekë
A) PASURI	907 984
Automjet “Audi A6”, blerë në datën 14.5.2012, zhdoganuar në datën 24.5.2012	1 005 891
Ndryshim likuiditeti	- 97 907
B) DETYRIME	0
C) PASURI NETO	907 984
D) TË ARDHURA	683 960

Të ardhura nga paga, subjekti i rivlerësimit	483 960
Të ardhura nga paga, personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit)	200 000
E) SHPENZIME	448 821
Shpenzime minimale jetese	333 821
Shpenzime arsimit për vajzën, K.D	90 000
Shpenzime udhëtimi brenda vendit, për në vendin e punës	25 000
BALANCA E FONDEVE (D-C-E)	- 672 845

39.7. Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht shpenzimet e kryera në vitin 2012 për blerjen e automjetit të markës “Audi”, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” të ligjit nr. 84/2016.

Pasuria e llojit likuiditete *cash*, gjendje në banesë, shuma prej 500,000 lekësh

40. Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të depozituara ndër vite në ILDKPKI konstatohet se subjekti i rivlerësimit në vazhdimësi ka deklaruar shtesa dhe pakësime të likuiditeteve gjendje *cash*.

40.1. Rezulton se të gjitha shtesat e likuiditeteve *cash* të konstatuara deri në vitin 2011, subjekti i ka deklaruar si burim krijimi pasurish, pra, si vlera të pakësuara/shpenzuara. Pra, bazuar në vetëdeklarimet e subjektit në fund të vitit 2011 gjendja e likuiditeteve *cash* është në vlerën 0 (zero) lekë. Ndërsa, në DIP/2012 subjekti nuk ka deklaruar shtesë pasurie në formë likuiditetesh *cash*.

40.2. Në vijim konstatohet se në seksionin e ndryshimeve të interesave privatë pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, në DIP/2013, subjekti ka deklaruar shtesë të gjendjes *cash* në banesë vlerën 500,000 lekë. Në DIP/2014, subjekti nuk ka deklaruar shtesa apo pakësime të gjendjes së likuiditeteve *cash*. Në DIP/2015 konstatohet se subjekti ka deklaruar shumën 100,000 lekë gjendje *cash*, me burim nga të ardhurat familjare për vitin 2015. Ndërsa në DIP/2016 ka deklaruar shumën 390,000 lekë si shtesë likuiditetesh *cash*.

40.3. Referuar vetëdeklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se në fund të vitit 2016 ai dispononte gjendjen e likuiditeteve *cash* në shumën 990,000 lekë.

Ndërkohë, në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” në datën 25.1.2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se disponon pasurinë e llojit likuiditete *cash* në vlerën 500,000 lekë.

40.4. Me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni kërkoi nga subjekti shpjegime mbi vetëdeklarimet e bëra ndër vite për likuiditetet *cash*, si edhe të deklaronte mbi destinacionin e shumës 490,000 lekë, e cila përfaqëson diferencën mes vlerës 990,000 lekë, konstatuar si shuma e gjendjes *cash* në datën 31.12.2016, bazuar në vetëdeklarimet e bëra ndër vite në ILDKPKI dhe vlerës 500,000 lekë, të deklaruar si gjendje likuiditetesh *cash* në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting”.

40.5. Në prapësimet e tij subjekti ka shpjeguar se në fillim të vitit 2017 ka bërë shpenzime për blerje mobiljesh (divanë të rinj) në shumën 180, 000 lekë. Gjithashtu ka bërë shpenzime për riparimin e makinës “Mercedes -Benz” në shumën 150, 000 lekë dhe se shpenzimet e tjera kanë qenë blerje telefonash për fëmijët.

40.6. Komisioni vëren se asnjë shpenzim i deklaruar nga subjekti, si i kryer në fillim të vitit 2017, nuk e kalon vlerën për të cilën, sipas ligjit, të ketë pasur detyrimin për deklarim në DIP/2017.

Çështje të tjera

Automjet në përdorim

41. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *ka përdorur automjetin e llojit “autoveturë”, marka “Volkswagen, 3C Passat”, me nr. shasie ***, me targa TR *** U, i cili aktualisht ka targat AA *** OS, në pronësi të F.B.*

41.1. Nga hetimi i kryer rezultoi se ky automjet më parë ka qenë në pronësi të shtetasit A.L dhe se subjekti rivlerësimit e ka përdorur atë edhe në periudhën që ka qenë në pronësi të këtij shtetasi.

41.2. Nga verifikimet e kryera në sistemin *TIMS* konstatohet se subjekti i rivlerësimit në vazhdimësi përgjatë viteve 2010 – 2019 e ka përdorur këtë automjet për udhëtime të kryera jashtë vendit.

41.3. Ndërsa, referuar të dhënave të përfituara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, konstatohet se subjekti i rivlerësimit është shënuar si përdorues në policat e sigurimit të këtij automjeti, të tipit “TPL” – për periudhat si vijon: (a) nga data 29.6.2011 deri në datën 28.6.2012; (b) nga data 28.6.2012 deri në datën 27.6.2013; (c) nga data 27.6.2013 deri në datën 26.6.2014; (d) nga data 8.7.2015 deri në datën 7.7.2016; dhe (e) nga data 7.7.2016 deri në datën 6.7.2017.

41.4. Rezultoi se subjekti i rivlerësimit është shënuar si përdorues edhe në policën e sigurimit të tipit “*Karton Jeshil*” për këtë automjet, e vlefshme për periudhën 1.9.2017 – 15.9.2017.

41.5. Gjithashtu, konstatohet se në policën e sigurimit të tipit “TPL” që i përket periudhës 15.7.2021 – 14.7.2022, si përdorues i këtij mjeti është shënuar djali i subjektit të rivlerësimit, K.D.

41.6. Rezulton se në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” (25.1.2017), subjekti i rivlerësimit e ka pasur në përdorim automjetin në fjalë, pasi ka pasur policë sigurimi të vlefshme në atë moment kohor, si edhe konstatohen udhëtime të kryera prej tij jashtë vendit në periudhë kohore të afërt para dhe pas dorëzimit të deklaratës “Vetting”.

41.7. I pyetur nga Komisioni³⁵ për periudhën në të cilën ai apo familjarët e tij kanë pasur në përdorim mjetin e sipërcituar, nëse vazhdojnë ta kenë në përdorim, si dhe të shpjegonte faktin se, edhe pse ka ndryshuar pronësia mbi automjetin, rezulton se kjo pasuri ka qenë në vazhdimësi në përdorimin e tij, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, deklaroi se *këtë makinë e ka përdorur dhe vazhdon ta përdorë herë pas here, sa herë ka nevojë, që nga viti 2011, kjo pasi me shtetasin F.B dhe familjen e tij ka miqësi të hershme familjare. Lidhur me faktin se makina është përdorur edhe në kohën kur ka qenë në emër të z. A.L ka deklaruar se z. B e ka blerë nga shtetasi L që në vitin 2010, por për arsye neglizhence nuk e ka bërë kalimin e pronësisë në kohën e blerjes, por rreth 6 vjet më vonë, në vitin 2016. Në mbështetje të deklarimeve të tij, subjekti i rivlerësimit ka depozituar deklaratë noteriale³⁶ të shtetasit F.B, datë 19.7.2021.*

41.8. Në përputhje me nenin D, pika 1 të Aneksit të Kushtetutës, si edhe në nenin 3, pika 11, nenin 31, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si edhe nenin 4 të ligjit nr. 9049/2003, “Për

³⁵ Pyetja nr. 1 (i, iii), e pyetësorit nr. 4.

³⁶ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.7.2021.

deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, subjekti ka pasur detyrimin ta deklarojë në deklaratën “Vetting” këtë pasuri në përdorim.

41.9. Referuar pikës 11 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, pasuri janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit.

41.10. Referuar pikës 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojnë ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

41.11. Ndërsa në pikën 1 të nenit 31 të ligjit nr. 84/2016 përcaktohet se subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon pranë ILDKPKI-së.

41.12. Nga sa u analizua më sipër, nga tërësia e rrethanave rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar përdorimin e këtij automjeti, në shkelje të detyrimit të deklarimit sipas nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

42. Lidhur me përdorimin e këtij automjeti, me dërgimin e prapësimeve, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur se: (i) nuk ka pasur detyrim për deklarim, pasi përdorimi i mjetit nuk ka qenë i përhershëm, por në raste të veçanta; (ii) nuk ka pasur asnjë të drejtë absolute në lidhje me këtë automjet, pasi vetëm e ka përdorur atë disa herë me pëlqimin e pronarit të tij, i cili gëzon të gjitha të drejtat reale mbi të; (iii) fakti që emri i subjektit është në policat e sigurimit, nuk do të thotë që ka të drejta reale mbi sendin dhe në këto kushte mendon se nuk ka pasur detyrim për të deklaruar përdorimin e tij; (iv) në asnjë rast nuk ka pasur për qëllim fshehjen e këtij fakti, por në gjykimin e tij nuk ka pasur detyrim për deklarimin e këtij fakti; (v) Komisioni duhet të mbajë parasysh edhe faktin se vlera e këtij automjeti nuk është e lartë dhe po të kishte qëllim fshehjen, nuk do të shënonte emrin në policat e sigurimit apo të udhëtonte jashtë shtetit me të.

Vlerësimi i Komisionit

43. Nga verifikimi i dosjes së këtij mjeti³⁷ konstatohet se ai është blerë në Gjermani nga shtetasi A.L, në datën 21.6.2010, për vlerën 10,460 euro dhe se në datën 23.6.2010 është bërë kontrolli fizik i tij në Shqipëri, në ambientet e Drejtorisë Rajonale të Transportit Rrugor Tiranë. Në datën 14.9.2016, shtetasi A.L ia ka shitur këtë³⁸ automjet shtetasit F.B.

43.1. Një analizë e thelluar e të dhënave *TIMS*, si dhe një analizë krahasuese e përdorimit të këtij mjeti, tregon se subjekti e ka përdorur këtë mjet në një numër të madh rastesh dhe se përdorimi i tij për periudhën 2010 – 2021, si dhe dalja e parë e subjektit me këtë automjet rezulton të jetë në 29 dhjetor të vitit 2010. Për më tepër, nuk rezulton që pronarët e këtij mjeti ta kenë përdorur atë për dalje jashtë vendit.

³⁷ Shkresa e DPSHTRR-së nr. *** prot., datë 22.7.2021.

³⁸ Kontratë shitblerjeje automjeti nr. *** rep., *** kol., datë 14.9.2016, redaktuar nga noteri publik, z. I.H.

43.2. Ndërsa, referuar të dhënave të përfituara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, konstatohet se subjekti i rivlerësimit është shënuar si përdorues në policat e sigurimit të këtij automjeti, për periudhën qershor 2011 – korrik 2017.

43.3. Komisioni konstaton se subjekti e ka përdorur në mënyrë të vazhdueshme këtë automjet, madje edhe pasi ka ndryshuar pronësia (pronari) mbi të, si dhe krijoi bindjen se ai e ka pasur në përdorim automjetin në fjalë edhe në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting”, pasi ka pasur policë sigurimi të vlefshme në atë moment kohor, si edhe konstatohen udhëtime të kryera prej tij jashtë vendit në periudhë kohore të afërt para dhe pas dorëzimit të saj.

43.4. Trupi gjykues çmon se shpjegimet e subjektit nuk paraqesin prova kundërshtuese, si edhe nuk i përgjigjen faktit se pse përdorimi i këtij automjeti nuk është deklaruar në deklaratën “Vetting”.

43.5. Për sa më sipër, trupi gjykues i qëndron konstatimit dhe rezultatit fillestar se subjekti i rivlerësimit, në lidhje me mosdeklarimin e përdorimit të automjetit në fjalë, është në kushtet e deklaramit të pasaktë dhe të paplotë të pasurisë në përdorim, në kundërshtim me sa parashikohet në nenin D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës.

43.6. Në vijim të hetimeve lidhur me këtë pasuri, Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime për marrëdhënien që ka pasur me shtetasit A.L dhe F.B, si dhe sa të shpeshta janë takimet e tij me këta shtetas, nëse ka udhëtuar ndonjëherë jashtë vendit me ta, si edhe të konfirmonte nëse ka gjykuar çështje gjyqësore civile/penale, ku si palë ndërgjyqëse/kallëzues/të kallëzuar/të pandehur/të dëmtuar etj., të kenë qenë shtetasit e sipërcituar. Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se³⁹ *me shtetasin F.B nuk ka udhëtuar asnjëherë jashtë shtetit dhe për shkak edhe të moshës kontaktet më të shpeshta me të i ka djali i tij K.D...por nuk përjashton ndonjë udhëtim drejt qytetit të Bajram Currit nëpërmjet Kosovës. Ndërsa sa i përket shtetasit L ka njohje me familjarët e tij, por me atë vetë nuk ka pasur takime, sepse nuk ka pasur ndonjëherë miqësi, përveç ndonjë përshëndetjeje korteziale, si dhe nuk ka udhëtuar ndonjëherë jashtë shtetit. Makinën e ka marrë në përdorim nga shtetasi F.B edhe kur ajo ka qenë në emër të z. L.*

43.7. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *nuk ka gjykuar çështje gjyqësore civile/penale, ku si palë ndërgjyqëse/kallëzues/të kallëzuar/të pandehur/të dëmtuar etj., të kenë qenë shtetasit F.B apo A.L.* Ka depozituar si provë vërtetimin e lëshuar nga Gjykata e Apelit Durrës⁴⁰.

43.8. Komisioni mori dijeni se për shtetasin A.L (identifikuar me gjeneralitetet të njëjta) janë kryer verifikime më parë në kuadër të procesit të rivlerësimit të kryer ndaj subjektit G.D.

43.9. Pasi administroi nga dosja fizike e G.D., (arkivuar në protokollin e Komisionit) hetimin e kryer për shtetasin A.L, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e anëtarit kryesues të trupit gjykues të Gjykatës së Rrethit Tropojë, pas kërkesës së bërë nga A.L me objekt “Rivendosje në afat të kërkesës për apelim të vendimit nr. ***, datë 27.10.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë”, me vendimin nr. ***, datë 4.12.2006, ka vendosur pranimin e kërkesës, pra rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit ndaj vendimit të sipërcituar, sipas të cilit ky shtetas ishte deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes me dashje”, duke u dënuar me 17 vite burg.

43.10. Pra, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka marrë në përdorim automjetin e sipërcituar (prej vitit 2010 sipas sistemit *TIMS* apo prej vitit 2011 sipas vetëdeklarimit), i cili të paktën deri në vitin 2016 ka qenë në emër të shtetasit A.L, megjithëse në dhjetor të

³⁹ Pyetja nr. 1 (ii) e pyetësorit nr. 4.

⁴⁰ Vërtetimi nr. *** prot., datë 21.7.2021.

vitet 2006 kishte shqyrtuar në cilësinë e kryesuesit të trupit gjykues, kërkesën e paraqitur nga ky shtetas për rivendosje në afat të kërkesës për apelim të vendimit nr. ***, datë 27.10.2000, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

44. Në lidhje me konstatimin e bërë nga Komisioni se në cilësinë e kryesuesit të trupit gjykues të Gjykatës Gjyqësor Tropojë, ka gjykuar një kërkesë të bërë nga A.L, subjekti ka sqaruar se *pasi është pyetur nga ana e Komisionit, është interesuar pranë gjykatave ku ka punuar dhe jo zyrtarisht i është konfirmuar se nuk ka gjykuar çështje me palë shtetasin A.L. Pas njohjes me materialet e dosjes rezulton se në vitin 2006 ai paska gjykuar një kërkesë për rivendosje në afat të këtij shtetasi. Gjykimi i kësaj çështjeje ka ndodhur në vitin 2006 dhe çështje të tilla zgjasin një seancë gjyqësore dhe bëhen zakonisht pa prezencën e të pandehurit. Në vlerësimin e tij është normale për një gjyqtar që të mos mbajë mend një seancë gjyqësore që ka ndodhur 15 vite më parë ndërkohë që zhvillon disa seanca gjyqësore në ditë.*

44.1. Në vijim, subjekti deklaron se *makinen nuk ia ka marrë asnjëherë shtetasit A.L, por shtetasit F.B, pavarësisht se në emër të kujt ka qenë e regjistruar makina në periudha të ndryshme. Makinen ka filluar ta përdorë në vitin 2011, rreth 5 vjet pasi ka gjykuar një kërkesë për rivendosjen në afat të këtij shtetasi.*

44.2. Gjithsesi ai pretendon se *edhe sikur ta kishte marrë në përdorim nga shtetasi A.L, gjë e cila nuk është aspak e vërtetë, mendon se nuk do të ishte në gjendjen e konfliktit të interesit në kuptim të ligjit.*

Vlerësimi i Komisionit/analiza e provave

45. Komisioni çmon se ky automjet i është lënë në përdorim subjektit nga shtetasi A.L, të paktën për periudhën 2010 – 2016. Në këto kushte, nisur nga situata faktike, përderisa ka rezultuar edhe nga policat e sigurimit se kishte të drejta përdorimi mbi këtë mjet, ai kishte detyrimin ta deklaronte këtë marrëdhënie në deklaratën “Vetting”, në zbatim të përcaktimeve të nenit 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, i cili, i parë në harmoni me nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, e detyronte subjektin ta deklaronte këtë automjet si pasuri në përdorim të tij.

45.1. Lidhur me konstatimin se subjekti kishte gjykuar një kërkesë të z. A.L në vitin 2006 dhe më pas, nga viti 2010 në vazhdim, ka përdorur automjetin në pronësi të tij, trupi gjykues vlerëson se, duke qenë që: a) gjykimi si rrethanë ka ndodhur disa vite më parë se të merrej ky mjet në përdorim; b) nuk rezulton që subjekti të ketë gjykuar çështje të tjera në themel apo procedurale me palë z. A.L; c) nuk provohet ndonjë marrëdhënie miqësie apo familjare me këtë shtetas dhe për më tepër subjekti ka deklaruar se e njeh vetëm si banor të qytetit të Bajram Currit; d) subjekti vazhdimisht ka deklaruar se e ka marrë këtë mjet në përdorim nga shtetasi F.B, për rrjedhojë, nuk provohet që subjekti të ketë pasur marrëdhënie interesash me z. L, dhe si e tillë, kjo marrëdhënie nuk përbën shkak për të cilësuar se subjekti gjendej në kushtet e konfliktit të interesave. Për rrjedhojë, Komisioni i çmon bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për këtë çështje.

45.2. Si përfundim, nga vlerësimi dhe analizimi në harmoni i rrethanave dhe fakteve të mësipërme, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit është në shkelje të detyrimit të deklarimit, sipas pikës D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 për pasuritë në përdorim.

Dhurim i deklaruar nga z. E.D, në vitin 2015, në shumën 3,000 paund

46. Komisioni konstaton se në deklarin e bërë veçmas në DIP/2015, personi i lidhur, djali i subjektit, K.D, në seksionin e ndryshimeve të pasurive dhe burimit të krijimit, ka deklaruar shumën prej 3,000 paund, të dhuruar nga djali i xhaxhait të tij, E.D, rezident në Angli, dhe se kjo shumë, pasi është kaluar në llogarinë e tij në “Raiffeisen Bank”, është tërhequr e gjitha për shpenzime të tij dhe të familjes.

46.1. Nga verifikimi i dokumentacionit nga “Raiffeisen Bank”⁴¹ konfirmohet se në datën 21.8.2015 në llogarinë e personit tjetër të lidhur në valutë (paund) është kredituar nëpërmjet transfertës shumë prej 3,000 paund, me përshkrim “*Student*”, me urdhërues E.D. Në vijim, rezulton se kjo shumë është tërhequr cash nga K.D, e konkretisht në datën 2.9.2015 ka tërhequr shumën prej 2,700 paund dhe, në datën 3.9.2015 ka tërhequr shumën 300 paund.

46.2. Referuar pikës 14 të nenit 3, si dhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, shtetasi E.D bën pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, në këtë rast, bazuar në parimin e proporcionalitetit, të provonte ligjshmërinë e burimit të të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumës prej 3,000 paundësh, pretenduar si të dhuruar në favor të subjektit të rivlerësimit në vitin 2015.

46.3. Pas kërkesës së Komisionit për depozitimin e dokumentacionit justifikues ligjor për burimin e të ardhurave të personit tjetër të lidhur, të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumës së dhuruar⁴² subjekti i rivlerësimit ka depozituar kopje të dokumentit njoftim për mundësi punësimi⁴³, i datës 9.2.2017, drejtuar z. E.D.

46.4. Komisioni konstatoi se dokumentacioni i dërguar gjatë hetimit administrativ nuk është në formën e kërkuar nga ligji dhe se, për më tepër, nuk referon të dhëna për të ardhura të mundshme të përfituara nga E.D, gjatë vitit 2015 apo për periudha të mëparshme.

46.5. Gjithashtu, nuk rezulton që z. E.D të ketë konfirmuar këtë marrëdhënie dhurimi, në përputhje me parashikimet e bëra në nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016.

46.6. Sa më sipër, me dërgimin e rezultateve të hetimit Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit duke i kërkuar që, personi tjetër i lidhur të konfirmonte këtë marrëdhënie dhurimi dhe nëse e konfirmonte, të depozitonte dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat, të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e shumës së pretenduar si të dhuruar në favor të personit të lidhur. Si rrjedhim, të ardhurat e pretenduara nga ky dhurim nuk u përfshinë në analizën financiare paraprake të kryer nga Komisioni.

46.7. Komisioni vëren se me dërgimin e prapësimeve, subjekti i rivlerësimit depozitoi prova të reja, në formën e kërkuar nga ligji, lidhur me këtë marrëdhënie të deklaruar dhurimi, e konkretisht dokumentacionin si vijon: (i) deklaratë noteriale e datës 9.9.2021, e shtetasit E.D, nëpërmjet të cilës ai konfirmon dhurimin e shumës 3,000 paund, sipas deklaramit të bërë nga personi i lidhur; (ii) vërtetim për pagimin e taksave nga shtetasi E.D për të ardhurat e tij nga punësimi për vitet 2015-2016; (iii) vërtetim për gjendjen e llogarisë bankare të shtetasit E.D. Subjekti kërkoi që këto të ardhura të deklaruara në formë dhurimi të konsiderohen të ligjshme dhe të përfshihen në analizën financiare.

46.8. Nga analizimi i dokumentacionit të paraqitur, konstatohet se shtetasi E.D ka përfiturar të ardhura neto nga punësimi për vitet 2015 - 2016, vlerën 16,700 paund.

⁴¹ Shkresa nr. *** prot., datë 12.7.2019.

⁴² Pyetja nr. 3 e pyetësorit nr. 2.

⁴³ Përkthyer nga përkthyesja S.D, konfirmuar firma e përkthyeses me vërtetim nënshkrimi nr. *** rep., datë 27.1.2020, të redaktuar nga noteri publik, znj. A.Ç.

Gjithashtu, rezulton se ka pasur gjendje në llogarinë e tij bankare, para dërgimit të shumës së dhuruar, vlerën 12,000 paund.

46.9. Trupi gjykues, pasi vlerësoi në tërësi këtë marrëdhënie dhurimi, analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe provat shkresore të paraqitura prej tij, arrin në përfundimin se personi tjetër i lidhur ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të mundësuar plotësisht shumën e dhuruar në favor të personit të lidhur në vitin 2015 dhe, për rrjedhojë, kjo shumë është përfshirë në analizën financiare përfundimtare.

Dhurim i deklaruar nga znj. D.D, në vitin 2016, në shumën 3,000 euro

47. Komisioni konstaton se në DIP/2016, në seksionin e të ardhurave dhe angazhimeve në veprimtari publike dhe/ose private, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shumën prej 3,000 euro, të ardhura nga halla D.D nga Belgjika, dhuratë për shkollimin e djalit K.D dhe të vajzës S.D, transferuar në llogarinë e djalit K.D në “Raiffeisen Bank”, tërhequr prej tij në datën 7.10.2016.

47.1. Nga verifikimi i informacionit/dokumentacionit të dërguar nga “Raiffeisen Bank”⁴⁴ konfirmohet se në datën 3.10.2016 në llogarinë e personit tjetër të lidhur valutë (euro) është kredituar nëpërmjet transfertës shuma prej 3,000 euro, me përshkrim “*për studime*”, me urdhërues D.D. Në vijim, rezulton se në datën 7.10.2016 kjo shumë është tërhequr *cash* nga K.D.

47.2. Referuar pikës 14 të nenit 3, si dhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, shtetasja Sh.D bën pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, në këtë rast, bazuar në parimin e proporcionalitetit, të provonte ligjshmërinë e burimit të të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumës prej 3,000 euro, pretenduar si të dhuruar në favor të subjektit të rivlerësimit/personave të lidhur, në vitin 2015.

47.3. Pasi kërkesës së Komisionit për të depozituar dokumentacion justifikues ligjor për burimin e të ardhurave të personit tjetër të lidhur, të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumës së dhuruar⁴⁵ gjatë hetimit administrativ subjekti i rivlerësimit ka depozituar: (i) vërtetim/deklaratë (shkresë e thjeshtë) e shtetasës D.D, e datës 16.8.2018; dhe (ii) kopje të dokumentit, njoftim për detyrimet tatimore për personin fizik, D.D (avokate)⁴⁶, për periudhën viti 2016, (datë lëshimi 12.2.2018); dhe (iii) kopje dokumenti transfertë bankare⁴⁷, e datës 30.9.2016.

47.4. Referuar vërtetimit të datës 16.8.2018, shtetasja D.D deklaron se në datën 30 shtator 2016 ka dërguar shumën prej 3,000 eurosh në rrugë bankare për nipin e saj, K.D, me banim në Tiranë.

47.5. Komisioni konstaton se referuar deklaratës së sipërcituar shtetasja D.D deklaron se ka kryer transfertën në shumën prej 3,000 eurosh në favor të K.D, por nuk ka deklaruar nëse ia ka dhuruar këtë shumë.

47.6. Gjithashtu, nga verifikimi i njoftimit për detyrimet tatimore për personin fizik, D.D, rezulton se për vitin 2016 të ardhurat neto të realizuara nga aktiviteti i avokatisë i kësaj

⁴⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 12.7.2019.

⁴⁵ Pyeteja nr. 3 e pyetësorit nr. 2.

⁴⁶ Dokument i përkthyer nga përkthyesja E.R, konfirmuar firma e përkthyeses me vërtetim nënshkrimi nr. *** rep., datë 27.1.2020, të redaktuar nga noteri publik, znj. A.Ç.

⁴⁷ Dokument i përkthyer nga përkthyesja E.R, konfirmuar firma e përkthyeses me vërtetim nënshkrimi nr. *** rep., datë 27.1.2020, të redaktuar nga noteri publik, znj. A.Ç.

shtetasje janë në vlerën 56,590 euro. Por, nga ana tjetër Komisioni konstatoi se ky dokument nuk është në formën e kërkuar nga ligji (i legalizuar me vulë apostile).

47.7. Sa më sipër, me dërgimin e rezultateve të hetimit Komisioni i kaloi barrën e provës subjektivit të rivlerësimit, duke i kërkuar që personi tjetër i lidhur të konfirmojë këtë marrëdhënie dhurimi dhe nëse e konfirmon, të depozitojë dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat, të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin shumës së pretenduar si të dhuruar. Si rrjedhim, të ardhurat e pretenduara nga ky dhurim nuk u përfshinë në analizën financiare paraprake të kryer nga Komisioni.

47.8. Komisioni vëren se me dërgimin e prapësimeve, subjekti i rivlerësimit depozitoi prova të reja, në formën e kërkuar nga ligji, lidhur me këtë marrëdhënie të deklaruar dhurimi, e konkretisht dokumentacionin si vijon: (i) deklaratë noteriale të shtetases D.D, nëpërmjet të cilës ajo konfirmon dhurimin e shumës 3,000 euro; (ii) vërtetim për ekstraktin e taksave si person fizik mbi të ardhurat e vitit 2016 dhe pagimin e tatimeve në Belgjikë.

47.9. Nga analizimi i dokumentacionit të paraqitur, rezulton se shtetasja D.D ka ushtruar aktivitet si person fizik, në vitin 2016, duke deklaruar një rezultat neto (pozitiv) në shumën 56,590 euro, nga të cilat deklaroi se shumën 3,000 euro e ka transferuar në rrugë bankare në favor të djalit të subjektivit (nipit të saj) në vitin 2016.

47.10. Trupi gjykues, pasi vlerësoi në tërësi këtë marrëdhënie dhurimi, analizoi shpjegimet e subjektivit të rivlerësimit dhe provat shkresore të paraqitura prej tij, arrin në përfundimin se personi tjetër i lidhur ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të mundësuar plotësisht shumën e dhuruar në vitin 2016 dhe, për rrjedhojë, kjo shumë do përfshihet në analizën financiare përfundimtare.

Të ardhurat e personit tjetër të lidhur

48. Komisioni konstaton se të ardhurat e deklaruar në deklaratat e interesave vjetorë, si të përfituara nga personi i lidhur (bashkëshortja e subjektivit) nga puna ndër vite, nuk përputhen me informacionin e referuar në dokumentacionin e depozituar me dorëzimin e deklaratës “Vetting”, si edhe me informacionin e dërguar nga ISSH-ja, të pasqyruara të dhënat përmbledhëse në tablën si më poshtë:

Tabela nr. 3.

Viti	Të ardhurat e deklaruar në DPV (Vlerat në lekë)	Të ardhurat si vërtetimeve të depozituara nga subjekti (Vlerat në lekë)⁴⁸	Të ardhurat neto sipas ISSH-së⁴⁹ (Vlerat në lekë)
2009	600,000		
2010	720,000	450,000	
2011	600,000	600,000	
2012	600,000	600,000	205,060
2013	500,000	341,204	339,912
2014	300,000	414,319	291,478

⁴⁸ Vërtetimi i shoqërisë “****” sh.a., datë 27.1.2014, dhe vërtetimi i shoqërisë “****” sh.p.k., datë 31.12.2016.

⁴⁹ Shkresa e ISSH-së nr. *** prot., datë 15.7.2019.

2015	480,000	480,000	490,000
2016	480,000	520,000	480,000
Totali	4,280,000	3,405,603	1,806,450

48.1. Në vijim të veprimeve verifikuese, Komisioni kërkoi nga subjekti depozitim e dokumentacionit justifikues ligjor⁵⁰ për të provuar përfitimin e të ardhurave nga punësimi dhe pagesën e detyrimeve tatimore përkatëse, e konkretisht për periudhën 2009 - 2013 nga puna e kryer në shoqërinë “****” sh.a., dhe për periudhën 2014 e në vijim nga puna e kryer në shoqërinë përmbarimore “****” sh.p.k.

48.2. Më dërgimin e përgjigjeve të pyetësorit nr. 3, për të provuar përfitimin e të ardhurave si edhe pagesën e detyrimeve tatimore nga punësimi i bashkëshortes në këto dy shoqëri, subjekti i rivlerësimit ka depozituar: (i) kopje të njësuar me origjinalin të librezës së sigurimeve shoqërore nr. ***, i cili referon të dhëna për periudhën prill 2010 – dhjetor 2013; (ii) si edhe vërtetimin për bazën e vlerësuar, shkakuar nga portali *e-albania*, i cili pasqyron të dhëna mbi të ardhurat e përfituara prej bashkëshortes së tij nga paga, për periudhën janar 2012 e në vijim.

48.3. Rezultoi se gjatë hetimit administrativ subjekti i rivlerësimit nuk depozitoi dokumentacion justifikues ligjor për të provuar të ardhurat e pretenduara nga punësimi i bashkëshortes për vitin 2009. Gjithashtu, konstatohet se në librezën e sigurimeve shoqërore (depozituar si provë nga subjekti) referohet informacion vetëm mbi pagesat e kryera për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën prill 2010 – dhjetor 2013, por nuk ka informacion për të ardhurat neto të përfituara nga personi i lidhur, si edhe për pagesa të mundshme të tatimit mbi të ardhurat e përfituara, për këtë periudhë. Ndërsa, informacioni i pasqyruar në vërtetimin për bazën e vlerësuar, shkarkuar nga portali *e-albania*, është i njëjtë me informacionin e administruar prej Komisionit nga ISSH-ja në kuadër të hetimit administrativ.

48.4. Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të provuar përfitimin e të ardhurave nga personi i lidhur, për periudhën 2009 -2011.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

49. Me dërgimin e prapësimeve subjekti ka pretenduar se Komisioni duhet të marrë në konsideratë deklaratimet e bëra prej tij dhe personit të lidhur në deklaratat periodike pranë ILDKPKI-së, në lidhje me të ardhurat nga paga dhe sipas kreditimit të pagës në bankë nga punëdhënësi “****”, duke argumentuar se, pavarësisht se për periudhën maj 2010 - shkurt 2013 paga është deklaruar në organet tatimore si pagë minimale prej 19,000 – 21,000 lekë në muaj, paga reale e përfituar nga bashkëshortja e tij është ajo e kredituar në bankë prej rreth 50,000 lekësh/muaj.

49.1. Subjekti ka depozituar si provë të re dokumentin “Vërtetim për bazën e vlerësuar”, i cili referon të dhëna të punësimit të bashkëshortes së subjektit në shoqërinë “****” sh.a., për periudhën maj 2010 – dhjetor 2011 dhe mban vulën e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier.

Vlerësimi i Komisionit/analiza e shpjegimeve dhe provave

50. Nga analiza e provave të depozituara nga subjekti, konfirmohet se personi i lidhur ka qenë në marrëdhënie punësimi që prej majit të vitit 2010, në shoqërinë shoqërinë “****”

⁵⁰ Pyetja nr. 2 e pyetësorit nr. 3.

sh.a., por, nuk dokumentohet punësimi i kësaj shtetase për periudhën nga viti 2009 – prill të vitit 2010.

50.1. Në vijim, në vlerësim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit në përputhje me qëndrimin e mbajtur nga ky trup gjykues, sipas të cilit punëdhënësi ka detyrimin dhe përgjegjësinë për pagimin e tatimit dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore për punëmarrësit, vlerat e të ardhurave neto nga paga do merret sipas kreditimeve mujore në llogarinë bankare të saj.

50.2. Për sa më sipër, Komisioni bëri ndryshimet përkatëse në analizën financiare përfundimtare, duke reflektuar të ardhura shtesë nga punësimi i personit tjetër të lidhur.

Dokumenti i aplikimit për legalizim në vitin 2007

51. Nga hetimi kryer rezultoi se bazuar në kërkesën e bërë nga subjekti i rivlerësimit në datën 5.7.2007, Njësia Bashkiake nr. ***, Tiranë⁵¹, ka bërë transferimin e gjendjes civile, duke i regjistruar atë dhe familjen e tij si banorë të kësaj njësie. Rezulton se bashkëngjitur kërkesës së bërë, për të provuar banimin në këtë njësi administrative, subjekti i rivlerësimit ka depozituar formularin e vetëdeklarimit për legalizimin e objektit “Shtojca A”, i datës 19.11.2006, në referim të së cilit ai shfaqet si një nga deklaruësit (deklaruësit e tjerë B.D dhe F.D) për ndërtimin e objektit informal me sipërfaqe ndërtimi 100 m², me dy kate, me sipërfaqe të zënë trualli prej 480 m², ndodhur në rrugën “****”, Tiranë. Sipas vetëdeklarimit të bërë, ky objekt është ndërtuar në vitin 2000.

51.1. Komisioni kërkoi nga subjektit⁵² deklarime/detaje lidhur me këtë objekt, periudhën e ndërtimit, investimet e kryera dhe vlerën e tyre, burimin e krijimit, statusin aktual të tij, si edhe mbi marrëdhënien e tij me vetëdeklaruësit e tjerë. Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit ndër të tjera deklaroi se *...formulari i datës 19.11.2006 (shtojca A1) nuk është dorëzuar prej tij në praktikën drejtuar Njesisë Administrative nr. ***, për lejen e banimit, dhe se ai personalisht në mënyrë kategorike nuk ka plotësuar apo nënshkruar asnjëherë formular vetëdeklarimi për legalizim objekti. Në dokumentet e praktikës së cituar, prej tij është është nënshkruar vetëm kërkesa për lejen e banimit.*

51.2. Në vijim të deklarimit ai ka shpjeguar se në korrik 2007 do të vinte me banim në Tiranë dhe duhet të regjistronte fëmijët në shkollë. Duke qenë se apartamenti që do të blinte, nuk kishte përfunduar ende, në marrëveshje me z. B.D bëri ndryshimin e gjendjes civile, duke vendosur adresën e këtij të fundit, si dhe duke bashkëngjitur formularit të vetëdeklarimit për legalizim (shtojca A1) të shtetasit B.D që mban datën 11.11.2006, e cila çuditërisht është zëvendësuar me formularin A1 pa vulë dhe me datë tjetër që gjendet në praktikën e lejes së banimit të lëshuar nga Njësia Bashkiake nr.***. Subjekti ka deklaruar se nuk ka pasur dijeni kush ka plotësuar edhe dorëzuar në emrin e tij këtë formular dhe ka pretenduar se edhe lehtësisht me sy të lirë mund të dallohet që nuk është shkrimi i tij.

51.3. Gjithashtu subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se *po qe se do të ishte vetëdeklaruësi i këtij objekti, ky formular do të ishte dërguar te ALUIZNI dhe do të kishte të dhëna për marrëdhëniet e tij pasurore për këtë objekt. Objekti në fjalë në praktikën e legalizimit që nga vetëdeklarimi deri në dhënien e lejes së legalizimit është vetëm në emrin e shtetasve B e F.D dhe ai nuk ka asnjë lidhje me këtë objekt.*

51.4. Në përfundim, subjekti ka sqaruar se *në shtator të vitit 2007 ka hyrë në apartamentin në të cilin banon edhe sot e kësaj dite, për të cilin ka dhënë shpjegime të detajuara në pyetësin nr.2. Ndodhur në kushtet kur nuk ka lidhje me pronësinë e këtij objekti, e vetmja*

⁵¹ Referohu shkresës së dërguar nga Njësia Bashkiake nr. ***, Tiranë, me nr. *** prot., datë 30.7.2020, dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj.

⁵² Pyetja nr. 1, pyetësi nr. 3.

lidhje me të cilin është për arsye të praktikës së lejes së banimit, nuk ka asnjë dijeni për periudhën e ndërtimit, investimet e kryera dhe vlerën e tyre. Lidhja e tij me vetëdeklaruesit e këtij objekti është lidhje farefisnore brezi i tretë.

51.5. Në mbështetje të deklaramëve të tij, subjekti i rivlerësimit ka depozituar: (i) deklaratë noteriale të z. B.D⁵³, e datës 5.7.2021, së bashku me formularin e vetëdeklarimit (Shtojca A1), kopje të lejes së legalizimit, si dhe certifikatës së pronësisë të objektit në fjalë⁵⁴; (ii) kopje të njësuar të praktikës të lejes së banimit, marrë nga Njësia Bashkiake nr. ***.

51.6. Nëpërmjet deklaratës noteriale të datës 5.7.2021, z. B.D, ka deklaruar se *shtëpia e banimit e ndodhur në zonën kadastrale ***, me nr. *** me sipërfaqe ndërtimi 100 m² dhe sipërfaqe trualli 480 m², sipas vetëdeklarimit të bërë në datën 11.11.2006 është ndërtuar vetëm prej tij dhe vëllait, shtetasit F.D dhe askush tjetër nuk ka pasur dhe nuk ka të drejta reale e pasurore mbi këtë pasuri. Më pas me kontratë shkëmbimi, në marrëveshje me vëllain F.D kjo pasuri është regjistruar vetëm në emrin e tij, gjë që provohet me nga certifikata e pronësisë nr. **, datë 14.5.2020. Shtetasi Izet Dushaj nuk ka asnjë lidhje me këtë pasuri, ai nuk ka qenë asnjëherë bashkëpronar, bashkëinvestitor apo bashkëndertues i kësaj pasurie.*

51.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje rezulton se legalizimi i kësaj pasurie është bërë bazuar në formularin e vetëdeklarimit për legalizimin e objektit “Shtojca A”, i datës 11.11.2006, në referim të së cilit shfaqen si vetëdeklarues të këtij objekti informal, z. B.D dhe z. F.D dhe se bazuar në këtë vetëdeklarim, është legalizuar ky objekt në vitin 2011 në emër të këtyre dy shtetasve (leje legalizimi nr. **, datë 29.3.2011).

51.8. Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim lidhur me këtë çështje, sikurse gjatë hetimit administrativ, duke ritheksuar faktin se në asnjë moment nuk ka qenë në dijeni për ekzistencën e dokumentit (i referohet formularit të vetëdeklarimit për legalizimin e objektit “Shtojca A”, i datës 19.11.2006), në referim të së cilit ai shfaqet si një nga deklaruesit e këtij objekti informal, duke sqaruar se ka ardhur në dijeni të tij vetëm pas dërgimit të pyetësorit nr. 3 nga Komisioni.

51.9. Si konkluzion, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ishte bindës në shpjegimet e tij dhe se nuk ka dyshime se ai mund të ketë kryer investime për këtë pasuri apo të ketë të drejta reale mbi të.

ANALIZA FINANCIARE për vitet 2003 – 2016

52. Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, deklaramet e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI, si edhe në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, pasi vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, Komisioni kreu analizën përfundimtare të treguesve financiarë lidhur me pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur, për çdo vit, për periudhën 2003 – 2016, nga ku rezulton se vitet 2005, 2007, 2009, 2010, 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016 paraqiten me balancë negative të fondeve e konkretisht: (i) për vitin 2005, balanca negative e fondeve (- 68,179 lekë); (ii) për vitin 2007, balanca negative e fondeve (- 8,274,007 lekë); (iii) për vitin 2009, balanca negative e fondeve (- 133,324 lekë); (iv) për vitin 2010, balanca negative e fondeve (- 449,057 lekë); (v) për

⁵³ Deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.7.2021, redaktuar nga noteri public, znj. V.K.

⁵⁴ Kopje të njësuar me origjinalin me dokumentin notarial nr. *** rep., datë 3.7.2021, redaktuar nga noteri publik, znj. M.Xh.

vitin 2012, balanca negative e fondeve (- 632,143 lekë); (vi) për vitin 2013, balanca negative e fondeve (- 33,364 lekë); dhe (vii) për vitin 2014, balanca negative e fondeve (- 31,448 lekë).

52.1. Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të konstatuara për vitet 2005, 2007, 2009, 2010, 2012, 2013, 2014, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” të ligjit 84/2016. (Totali i balancës negative për periudhën 2003 – 2016, është në shumën prej 9,621,522)⁵⁵.

Konkluzioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe vlerësimi tërësor i çështjes

53. Mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimeve, si dhe provat shpresore të administruara në dosje, lidhur me kriterin e vlerësimit pasuror, trupi gjykues konkludon se:

53.1. Lidhur me pasurinë e llojit “apartament”, me sipërfaqe 158 m², të ndodhur në Tiranë, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar pagesën e çmimit për blerjen e tij.

53.2. Lidhur me automjetin e markës “Audi”, blerën në maj të vitit 2012, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar pagesën e çmimit për blerjen e tij.

53.3. Lidhur me përdorimin e automjetit të markës “Volkswagen Passat”, rezultoi se subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting” nuk ka deklaruar në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, ndaj ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë të pasurisë në përdorim.

53.4. Referuar analizës financiare subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të konstatuara për vitet 2005, 2007, 2009, 2010, 2012, 2013 dhe 2014, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” të ligjit nr. 84/2016.

53.5. Komisioni, bazuar në konkluzionet e mësipërme, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, konkludon se subjekti nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2 të nenit 4, si edhe pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar nenit 58, pika 1, germa “c”, si dhe nenit 61,

⁵⁵ Tabela e analizës përmbledhëse financiare, ndodhur në Aneksin, pjesë e këtij vendimi.

pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Izet Dushaj, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës.
2. Vendimi i arsyetuar u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik, vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 23.9.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes SHULI
Kryesuese

Olsi KOMICI
Anëtar

Pamela QIRKO
Relatore

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi

ANEKS 1 – TABELA PËRMBLEDHËSE E ANALIZËS FINANCIARE

	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
A) PASURI	0	0	531,959	164,806	8,558,378	-1,993,856	403,885	869,729	-1,046,118	887,973	566,040	35,224	-55,265	1,027,989
Apartament me sip. 158 m ² i ndodhur në Tiranë.					7,254,600									
Automjet I markës Audi A6, blerë në datë 14.05.2012,										1,005,891				
Automjet I markës Daimler Chrysler tip C***CDI, blerë në datë 26.07.2016														600,000
Ndryshim likuiditeti	0	0	531,959	164,806	1,303,778	-1,993,856	403,885	869,729	-1,046,118	-117,918	566,040	35,224	-55,265	427,989
B) DETYRIME	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
C) PASURI NETO	0	0	531,959	164,806	8,558,378	-1,993,856	403,885	869,729	-1,046,118	887,973	566,040	35,224	-55,265	1,027,989
D) TË ARDHURA	676,385	1,072,082	1,121,122	1,270,201	1,164,091	1,244,374	1,280,281	1,777,717	1,787,421	1,830,260	1,570,883	1,607,830	2,391,064	3,427,888
Të ardhura nga paga Izet Dushaj	676,385	1,072,082	1,121,122	1,270,201	1,164,091	1,244,374	1,280,281	1,327,717	1,187,421	1,230,260	1,229,679	1,307,830	1,341,294	1,362,023
Të ardhura nga paga Sh.D								450,000	600,000	600,000	341,204	300,000	490,000	480,000
Të ardhura nga paga K.D														190,055
Të ardhura nga paga K.D														
Të ardhura nga apartamenti prej 82m ² , e shitur në Bajram Curri														
Të ardhura nga shitja e automjetit Audi A6														990,000
Të ardhura nga dhurimi I vëllait E.D														
Të ardhura nga dhurimi I djalit të vëllait E.D													559,770	
Të ardhura nga dhurimi I motrës D.D														405,810
E) SHPENZIME	469,320	524,074	657,342	657,342	879,720	879,720	1,009,720	1,357,045	1,221,720	1,574,430	1,038,207	1,604,054	2,133,839	2,323,541
Shpenzime minimale jetese	469,320	524,074	657,342	657,342	819,720	819,720	819,720	819,720	819,720	846,144	846,144	1,319,988	1,345,656	1,410,552
Shpenzime arsimit për K.D													268,418	236,723
Shpenzime arsimit për K.D								72,000	162,000	162,000	90,000			
Shpenzime arsimit për S.D													346,000	355,500
Shpenzime mobilimi shtëpia në Tiranë							130,000		180,000	150,000		140,000	100,000	180,000
Shpenzime udhëtimit brenda vendit për në vendin e punës					60,000	60,000	60,000	60,000	60,000	60,000	60,000	60,000	60,000	60,000
Shpenzime udhëtimit jashtë vendit	0	0	0	0	0	0	0	405,325	0	356,286	42,063	84,066	13,765	80,766
Balanca e Fondeve (D-C-E)	207,065	548,008	-68,179	448,053	-8,274,007	2,358,510	-133,324	-449,057	1,611,819	-632,143	-33,364	-31,448	312,491	76,358